



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Degës Doganore Rinas

Tiranë, prill 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	6
II.	HYRJA	7
1.	Objektivat dhe qëllimi	8
2.	Identifikimi i çështjes	8
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4.	Përgjegjësitë e audituesve	9
5.	Kriteret e vlerësimit	9
6.	Standartet e auditimit	10
7.	Metodat e auditimit	10
8.	Dokumentimi i auditimit	11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	
III.2.1.	Auditimi i programimit dhe realizimit të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.	11
III.2.2.	Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.	14
III.2.3.	Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori regjime/përrjashtime gjatë mbikëqyrjes doganore të regjimeve ekonomike për RPA dhe RLP.	25
III.2.4.	Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.	32
III.2.5.	Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim.	66
IV.	REKOMANDIME	69

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1269/1 prot., datë 23.10.2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Degën e Doganore Rinas, për periudhën 01.07.2022 deri më 31.12.2024.

Dega Doganore Rinas është një njësi funksionale e miratuar që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kjo degë doganore mbulon operacione të deklarimit doganor të mallrave dhe zhdoganimit të tyre duke mundësuar lehtësimin e procedurave doganore për hedhjen e mallrave në territorin doganor si dhe kryerjen e procedurave të tjera doganore, tranzitim, magazinim, eksportim etj.

Misioni i Degës Doganore Rinas, është ;

- mbledhja e të ardhurave doganore, garantimi i interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar,

- mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;

- garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera.

Nëpërmjet zbatimit të:

- Parimit të mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë.

- Parimit të mbështetjes së konkurrueshmërinë së kompanive shqiptare.

- Parimit të lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme.

- Parimit të kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave.

- Parimi të bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjensive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Në mbështetje të planit vjetor të vitit 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer auditimi i këtij institucioni duke kontribuar kështu në realizimin e vizionit të KLSH-së për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike si dhe për vetë rëndësisë që ka auditimi i njërive doganore të cilat kontribuojnë në mbledhjen e të ardhurave për Buxhetin e Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.07.2022 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.

2. Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.
3. Auditimi i procedurave doganore të ndjekura në lidhje me veprimtarinë e regjimeve doganore ekonomike, magazinimit të përkohshëm dhe tranziteve, për periudhën nën auditim.
4. Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.
5. Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim.
6. Auditimi i problemeve të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit për periudhën nën auditim.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse: Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit; Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit; Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 13 gjetje dhe ka dhënë 13 rekomandime, për masa organizative 8 rekomandime dhe për të ardhura të munguara 5 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga auditimi mbi procedurat doganore në lidhje me vlerësimin dhe importimin e artikujve "pajisjeve mjekësore" konstatohet se nuk janë zbatuar procedurat për kryerjen e kontrollove dokumentare dhe fizike lidhur me importin e implanteve mjekësore, si grup artikujsh që përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja. Disa nga këto produkte në import janë përjashtuar padrejtësisht nga pagimi i TVSH-së në import. Këto veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të Kodit Doganor nën 47, 169, 173 të këtij kodi. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023, në 6 raste është konstatuar përjashtim i padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import me pasojë të ardhura të munguara për TVSh dhe sanksionet në vlerën 3-fish të detyrimit, në total në vlerën 11,689,144 lekë, si dhe për vitin 2024 në 6 raste në vlerën totale 22,574,568 lekë. Për të 12 praktikatat e evidentuara me mangësi, në referencë të nenit 251, pika 2 të Kodit Doganor duhet të penalizohen edhe agjencitë doganore me gjobë në shumën 50,000 lekë/rast, në total për periudhën objekt auditimi në shumën 600,000 lekë. Për sa më sipër, të ardhurat e munguara konstatohen në vlerën 34,863,712 lekë.

- Nga auditimi mbi importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 *Smartphones* të NKM, me origjinë EU/NEU konstatohet se gjatë vitit 2023 në 30 raste dhe në vitin 2024 në 9 raste në Degën Doganore Rinas, për artikujt e këtij kapitulli janë konstatuar vlerësime të gabuara pasi nuk janë kryer në përputhje me Kodin Doganor, metodën

nr.3 te vlerësimit, bazuar ne Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor, ne mungese te dokumentacionit te nevojshëm për pranimin e transaksionit, si edhe bazuar ne origjinën e artikujve.

Këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në nenet 66-70 dhe 251 të Kodit Doganor, udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” dhe udhëzimit nr.5 datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarde të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit aposterior operativ” pika IV, procedurat që ndiqen nga SKAO. Efekti financiar i të ardhurave të munguara si pasojë e vlerësimit të gabuar për kodin tarifor “85171300” për vitin 2023 paraqitet në shumën 5,478,299 lekë, konstatuar në 30 raste dhe për vitin 2024 paraqitet në shumën 3,564,919 lekë, konstatuar në 9 raste, në total për periudhën objekt auditimi në shumën 9,043,218 lekë.

- Nga auditimi konstatohet se ka mos përfshirje në vlerën për qëllime doganore të mallrave me skonto. Kjo është konstatuar në importet dhe deklaratimet e artikujve të përfshirë në kapitullin “12. Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta te ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia”, të NKM, me origjinë EU/NEU.

Gjatë vitit **2023** në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë përpunuar 275 deklarata me vlerë të deklaruar 603,796,236 lekë dhe kanë rezultuar 8 deklarata të përpunuara në procedurat e ndjekura për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore me mangësi. Efekti financiar i përllogaritur rezulton **1,639,480** lekë e cila përbën të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Gjatë vitit 2024 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë përpunuar 279 deklarata me vlerë të deklaruar 559,180,777 lekë dhe kanë rezultuar 5 deklarata të përpunuara me mangësi. Efekti financiar i përllogaritur rezulton **827,186** lekë e cila përbën të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Të ardhurat e munguara në total në shumën 2,466,666 lekë janë konstatuar pasi në këto deklarata nuk janë përfshirë mallrat me skonto, duke mos zbatuar dispozitat ligjore të parashikuar në nenet 66-70 të Kodit Doganor si dhe udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura lidhur me vendimet doganore nga Dega Doganore Rinas u konstatua mostrajtimi i drejtë i shkeljeve doganore, klasifikim i gabuar në 6 raste i shkeljeve doganore dhe sanksioneve të vendosura në nenet 251 dhe 256 të Kodit Doganor duke sjellë penalitet të munguar në shumën 272,212 lekë, veprime në kundërshtim me nenet 251, 256, 252, 257 të Kodit Doganor.

- Nga auditimi i procedurave të verifikimit të shkeljeve doganore të ndjekura nga Dega Doganore Rinas, strukturat verifikuese e konstatuese të shkeljeve doganore u konstatuan mangësi në përmbajtjen e proces verbaleve të shkeljeve doganore lidhur me mungesën e neneve te shkelura, të sanksioneve te vendosura, mos dokumentimit të njoftimit të shkeljeve dhe mos dokumentim të plotë të praktikës së shkeljeve doganore, në kundërshtim me nenet 273,274 dhe 276 të Kodit Doganor.

- Nga auditimi i përputhshmërisë se procedurave doganore lidhur me veprimtarinë e Regjimit të Përpunimit Aktiv dhe RLP konstatohet: Mangësi si moskryerje të kontrolleve dokumentare apo fizike të regjimit dhe mangësi në përmbajtjen e dosjes së regjimit, mungesë të raporteve për cdo kontroll të kryer apo akt rakordimet e mbajtura. Veprime në kundërshtim me pikën XIII . Mbikëqyrja e regjimit, me pikën XV. Detyrimet e doganierit mbikëqyrës të Udhëzimit nr.4, datë 28.09.2018 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

- Nga auditimi i përputhshmërisë se procedurave doganore lidhur me veprimtarinë e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm konstatohet: mos kryerjen e kontrolleve periodike tre mujore dhe lidhur me mallrat që u ka kaluar afati 90 ditor konstatohet mos rregullim të situatës së tyre në përputhje me nenet 139, 137/4,178, 179 dhe 180 të Kodit Doganor.

Veprime në kundërshtim me: Neni 139 Përfundimi i magazinimit të përkohshëm të Kodit Doganor ; Neni 137 Kushtet dhe përgjegjësitë për magazinimin e përkohshëm të mallrave.

- Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitor të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Degës Doganore Rinas për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Degës Doganore Rinas për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 90,139,640 lekë. Ndërsa sektori borxhit në fund të vitit 2022 raporton se borxhit doganor është në vlerën 8,675,083 lekë. Nga analizimi konstatohet se kemi diferenca midis kontabilitetit dhe sektorit të borxhit në vlerën 81,464,557 lekë. Këto veprimet janë në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 3.2 trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (Klasa 4).

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

- Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritura në shumën 34,863,712 lekë.

- Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritura në shumën 9,043,218 lekë.

- Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rillogaritura në shumën 2,466,666 lekë.

- Dega Doganore Rinas në proces verbal të mbajtura dhe vendimet e marra të bëjë trajtimin e drejtë të klasifikimit dhe sanksioneve të vendosura të shkeljeve doganore, të bashkëlidhë dokumentacionet që lidhen me shkeljen që provojnë/argumentojnë kundërvajtjen, aplikimi i nenit 251 pika 2 shkronja “a” të Kodit Doganor nuk duhet të ngatërrohet me nenin 252 pika “d” të Kodit Doganor, ku ky i fundit lidhet me detyrimet e përcaktuara në nenin 130 të Kodit Doganor.

- Dega Doganore Rinas në procedurat e verifikimit të shkeljeve doganore, në përmbajtje të proces verbaleve të verifikimit /konstatimit të shkeljeve doganore të vendosë nenet e shkelura, nenet e sanksioneve të vendosura, të dokumentojë njoftimet e tyre dhe të bëjë dokumentimin e plotë të praktikës së shkeljeve doganore.

- Dega Doganore Rinas, doganierët mbikëqyrës së Regjimit të Përpunimit Aktiv dhe RLP të kryejnë kontrolle dokumentare apo fizike, të mbajnë raporte për çdo kontroll të kryer apo akt rakordimet e mbajtura, plotësojnë përmbajtjen e dosjes së regjimit sipas pikës XIII. Mbikëqyrja e regjimit dhe pikës XV. Detyrimet e doganierit mbikëqyrës të Udhëzimit nr.4, datë 28.09.2018 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

-Dega Doganore Rinas, doganierët mbikëqyrës së Regjimit Magazinimit të Përkohshëm të kryejnë kontrolle çdo tre muaj të marrin të gjitha masat për rregullimin e situatës së mallrave që u ka kaluar afati i qëndrimit 90 ditë sipas parashikimeve të neneve 139, 137/4,178, 179 dhe 180 të Kodit Doganor.

- Dega Doganore Rinas, Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Borxhit të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për rakordimin e llogarisë nr.468, për diferencën në vlerën 81,464,557 lekë, me evidencat e detyrimeve doganore të papaguara me qëllim sistemin e tyre në vlerën e saktë të debitorëve.

Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit të përputhshmërisë

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Degës së Doganës Rinas. me kriteret e vlerësimit në kuadrin ligjor që përfshin ligjin nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 92 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, etj dhe aktet nënligjore për rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës, duke u fokusuar në realizimin e të ardhurave doganore, masat e ndërmarra për rikuperimin e borxhit doganor, procedurat e ndjekura mbi vendimet administrative, vlerësimin doganor, autorizimet e regjimeve doganore dhe atyre të akcizës, për periudhën 01.07.2022-31.12.2024.

Opinion i modifikuar/kualifikuar¹

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Degës Doganore Rinas, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar të përputhshmërisë:

- Nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të vlerësimit doganor të mallrave; klasifikime tarifore jo në përputhje me përcaktimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë (RSH);

-Janë konstatuar raste ku për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar është trajtuar me transaksion, edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për t’u trajtuar si i tillë; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar dhe për raste të tjera jo; trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; veprime jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor duke rezultuar me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën **46,763,697 lekë**.

-Gjithashtu janë konstatuar problematika lidhur me masat e ndërmarra si për vjeljen ashtu dhe për raportimin e borxhit doganor, duke mos përlllogaritur saktë kamatëvonesat; apo mos marrjen në kohë të vendimit administrativ nga autoriteti doganor, pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse për konstatimet e problematikave.

- Janë konstatuar mangësi në vendimmarrjen lidhur me problematikat e konstatuara të vendimeve administrative për subjektet që operojnë pranë kësaj dogane, si dhe në autorizimet e magazinave fiskale, RLP dhe RPA.

¹ Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1269/1 prot., datë 23.10.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.10.2024 deri më datë 31.01.2025, në subjektin Dega e Doganës Rinas për periudhën e aktivitetit nga 01.07.2022 - 31.12.2024, është kryer auditimi me objekt: “Auditim Përputhshmërie” nga grupi i auditimit:

1. A.B, Përgjegjës Grupi;
2. I.F, Auditues;
3. F.D, Auditues.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit të përputhshmërisë në Degën Doganore Rinas është vlerësimi i rregullshmërisë financiare e subjektit të audituar përgjatë periudhës 01.07.2022 deri në 31.12.2024 për përputhshmërinë dhe dhënien e opinionit të përputhshmërisë mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI. Gjithashtu objektivat përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)²; dhe hartimin e Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

- Evidentimi i shmangieje të veprimtarisë me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit;
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me zbatimin e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit;
- Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash etj;
- Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit;
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës;
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen;
- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

Identifikimi i çështjes. Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Degës Doganore Rinas dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve. Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së

²Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Projekt Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të Degës së Doganës Rinas janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave doganore, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e vlerësimit doganor, etj. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Degës së Doganës Rinas janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Degën Doganore Rinas, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit.

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DDR, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin doganor në Republikën e Shqipërisë. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

Standardet e Auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 400-499; 4000-4899; 4900 etj.;

- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);

- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;

- Manuali mbi Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të KLSH;

- Manuali mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;

Akte ligjore:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

- Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”;

- Ligjin nr. 8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar;

- Akte nënligjore:

- VKM nr. 651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të KD”;

- VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për Akcizat”, i ndryshuar;

Rregullore:

- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”

- Rregullore mbi Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, etj.

-Standardet e auditimit.

-ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;

-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;

-Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

-Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

Metodat e auditimit. Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

-Risku i lidhur me të ardhurat specifike; dhe

-Pesha specifike që një zë të ardhurash zë ndaj totalit të të ardhurave të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit.

- Kontrolli aritmetik
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese
- Kontrolli i vlerësimeve
- Konfirmimi nga të tretët
- Kontrolli sipas një treguesi
- Intervista
- Raporte dhe Informacione
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK

Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Aktet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projekt Raport Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm.

Auditimi i këtij institucioni lidhur me realizimin e të ardhurave kundrejt planit, buxhetit, dhe vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së sektorëve të Degës Doganore Rinas ka një rëndësi të veçantë, lidhur me transparencën e veprimtarisë në këtë fushë, impaktin financiar në buxhetin e shtetit si dhe zbatimin e parimeve të tregtisë së lirë . Për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, nga mangësitë në aplikimin e kriterëve të duhura ligjore gjatë procesit të vlerësimit doganor.

Drejtoria Doganore Rinas është një institucion buxhetor në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e ngarkuar për administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave doganore në formën e taksës doganore, taksave kombëtare të ngarkuara me ligj për tu mbledhur, detyrime doganore në formën e TVSh-së, dhe të tjera detyrime për tu paguar në Buxhetin e Shtetit që ja ngarkon legjislacioni fiskal në RSH si dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe objektivave institucional, në funksion të promovimit të transparencës së duhur në marrëdhëniet me subjektet dhe operatorët deklarues, duke siguruar sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë riskun e korrupsionit, dhe trajtimin e paanshëm dhe të barabartë për të gjithë importuesit dhe deklaruesit e mallrave. Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) sipas programit buxhetor “*Menaxhimi i të ardhurave Doganore*”, pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave.

Kuadrin rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e Degës Doganore Rinas, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloret e Brendshme të miratuara nga Ministria e Financave. Gjithashtu Dega Doganore Rinas ka si objektiva kryesore:

-Sigurimin e mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve dhe taksave nëpërmjet rritjes së efikasitetit në punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore;

-Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtareve dhe subjekteve që operojnë nëpër Degë Doganore duke krijuar lehtësi në lëvizje, e kontroll eficient duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditimi i programimit dhe realizimit të ardhurave doganore për periudhën nën auditim.

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Të dhëna mbi planifikimin dhe realizimin e të AD, sipas strukturës së tyre për vitet 2022-2024;
- Të dhëna mbi realizimin e të AD, në analizë krahasuese për periudhën 2022-2024.

Auditimi mbi të Ardhurat Doganore (AD) u fokusua në drejtimit e mëposhtme:

- Planifikimi i të ardhurave dhe realizimi i tyre, për vitet 2022- 2024, analizë treguesish;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave nga DDT, në analizë krahasuese për periudhën 2022-2024;

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti DDT mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për vitin 2022-2024 ka rezultuar si më poshtë:

Periudha	Plani 2022	Fakti 2022	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt
2022	2,693,395	2,777,356	83,961	103

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2022, të ardhurat doganore paraqiten me tejkallim në masën 3% ose në shumën 83,961 mijë lekë.

Periudha	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizimi në % 2023/2022
2023	2,777,356	3,101,230	3,209,097	107,867	103	111

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2023, të ardhurat doganore paraqiten me tejkallim në masën 3% ose në shumën 107,867 mijë lekë, krahasuar me faktin e vitit 2022 të ardhurat janë realizuar me tejkallim në masën 11% ose në shumën 431,741 lekë.

Periudha	Fakti 2023	Plani 2024	Fakti 2024	Diferenca plan/fakt	Realizimi në % plan/fakt	Realizimi në % 2024/2023
2024	3,209,097	3,201,294	3,745,463	544,168	117	116.7

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, në vitin 2024, të ardhurat doganore paraqiten me tejkallim në masën 17% ose në shumën 544,168 mijë lekë, krahasuar me faktin e vitit 2023 të ardhurat janë realizuar me tejkallim në masën 16.7% ose në shumën 536,366 lekë.

Të ardhurat Doganore viti 2022-2023 (sipas llojit të taksave)

Në 000/lekë

Llojet e taksave	Plani			Realizimi/Fakt			Realizimi në %		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Taksë dog.	149,550	143,536	201,215	154,405	160,939	196,934	103%	112%	98%
Akcizë	67,337	42,668	30,967	54,073	28,312	26,664	80%	66%	86%
TVSH	2,476,510	2,915,026	2,969,112	2,568,877	3,019,845	3,521,865	104%	104%	119%
Renta	0	0	0	0	0		0%	0%	0%
Totali	2,693,396	3,101,230	3,201,279	2,777,356	3,209,097	3,745,463	103%	103%	117%

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

Sa sipër rezulton se për vitin 2022 dhe për vitin 2023 kemi një mosrealizim të Akcizës respektivisht në vlerën -13,263 mijë lekë dhe -14,356 mijë lekë, ndërsa taksa doganore është planifikuar më e ulët se plani i vitit 2023 në vlerën 17,403 mijë lekë më pak.

Për vitin 2024 rezultojnë me një mosrealizim Taksa doganore në vlerën -4,271 mijë lekë si dhe mosrealizim të Akcizës në vlerën -4,303 mijë lekë.

Mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave doganore.

▪ **Taksa Doganore:**

Të ardhurat nga “Taksa doganore” për vitet 2022 dhe 2023, respektivisht rezultojnë me **realizim në vlerën 154,405 mijë lekë dhe 160,939 mijë lekë**, ose në masën 103% dhe 112%, kundrejt planit. Për vitin 2024 konstatohet një mosrealizim në vlerën -4,271 mijë lekë ose në realizim në masën 98%. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme, ku sipas të dhënave për vitin 2023 dhe 2024 rezultojnë me mosrealizim në disa muaj. Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri është ndryshimi i kursit të këmbimit nëpërmjet mbi çmimit të lekut.

Në 000/lekë

Viti	2022			2023			2024		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	9,425	9,570	102	10,676	9,962	93	11,260	17,312	154
Shkurt	11,235	11,241	100	11,471	10,890	95	17,610	12,434	71
Mars	12,676	12,678	100	11,971	10,679	89	16,075	15,298	95
Prill	10,277	10,277	100	10,910	9,840	90	18,136	16,389	90
Maj	13,890	13,884	100	12,845	14,044	109	16,246	15,432	95
Qershor	12,394	12,388	100	11,740	12,499	106	17,537	15,984	91
korrik	12,042	12,047	100	13,354	13,902	104	18,923	15,236	81
Gusht	13,804	14,113	102	13,106	10,904	83	16,100	13,863	86
Shtator	12,883	13,956	108	12,787	14,171	111	17,319	13,801	80
Tetor	13,043	13,592	104	10,386	18,057	174	16,818	19,941	119
Nëntor	12,981	15,037	116	11,209	15,735	140	16,913	16,479	97
Dhjetor	14,900	15,624	105	13,081	20,255	155	18,262	24,759	136
Totali	149,550	154,405	103	143,536	160,939	112	201,200	196,928	98

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

▪ **Të ardhura nga Akciza:**

Të ardhurat nga “Akciza” për vitet 2022-2024 rezultojnë me **mosrealizim në vlerën -13,266 mijë lekë ose realizim në masën 80% për vitin 2022, mosrealizim në vlerën -14,356 mijë lekë ose realizim në masën 66% për vitin 2023 dhe mosrealizim në vlerën -4,303 mijë lekë ose realizim në masën 86% për vitin 2024**, kundrejt planit. Realizimi i tyre sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme, ku sipas të dhënave rezultojnë me mosrealizim të ndjeshëm muajt Shtator-Dhjetor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 muaj Janar, Mars dhe periudha Maj-Dhjetor.

Planifikimi vjetor i të ardhurave nga akciza, për vitin 2023 krahasuar me faktin e vitit 2022 ka pasur një ulje të ndjeshme e cila është parashikuar në shumën -11,402 mijë leke, pavarësisht uljes së planifikuar e cila nuk argumentohet në planifikim e arkëtimit të kësaj takse ka një mosrealizim i cili krahasuar me faktin arrin në shumën -25,758 mijë lekë ose me mosrealizim

plan/fakt në masën 48%. Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri është ndryshimi i kursit të këmbimit nëpërmjet mbi çmimit të lekut.

Në 000/lekë

Viti	2022			2023			2024		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	816	1,237	152	4,124	1,147	28	2,076	4,145	200
Shkurt	2,206	2,237	101	1,144	8,992	786	4,078	1,145	28
Mars	3,859	3,870	100	4,695	813	17	2,772	725	26
Prill	3,436	3,470	101	3,597	3,899	108	2,139	549	26
Maj	24,815	24,826	100	4,687	2,592	55	1,997	3,766	189
Qershor	2,022	2,036	101	4,832	1,433	30	2,552	2,395	94
korrik	2,240	2,240	100	3,916	2,007	51	2,654	3,808	144
Gusht	4,792	4,635	97	4,098	1,243	30	3,308	1,769	53
Shtator	6,584	1,735	26	2,859	2,116	74	2,408	424	18
Tetor	5,632	3,175	56	2,824	3,138	111	2,170	3,276	151
Nëntor	5,148	2,051	40	3,044	317	10	2,324	2,347	101
Dhjetor	5,787	2,557	44	2,848	615	22	2,490	2,315	93
Totali	67,337	54,070	80	42,668	28,312	66	30,967	26,664	86

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

▪ Të ardhura nga TVSH:

Të ardhurat nga TVSH, paraqiten me realizim për vitet 2022 dhe 2023 në masën 104%, kundrejt planit, në vitin 2024 realizimi i TVSH-së është në masën 119%. Në përgjithësi është ruajtur i njëjti trend i realizimit të tyre gjatë periudhave mujore. Me nivelin më të ulët të realizimit paraqitet muajt Nëntor 2022 në masën 98% dhe muaji Shkurt në masën 97% dhe Tetor 2023 në masën 95%, me nivel më të lartë realizim janë muajt Gusht-Shtator 2022 dhe muaji Dhjetor 2023.

Në 000/lekë

Viti	2022			2023			2024		
	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %	Plan	Fakt	Ne %
Janar	173,850	173,282	100	201,629	205,320	102	211,590	195,265	92
Shkurt	197,562	197,604	100	249,184	241,918	97	302,779	394,387	130
Mars	212,526	212,493	100	267,771	272,944	102	206,397	209,725	102
Prill	211,199	211,204	100	223,381	224,149	100	220,235	284,822	129
Maj	199,152	199,145	100	219,861	220,757	100	276,576	301,269	109
Qershor	194,967	194,974	100	214,178	216,817	101	230,419	281,036	122
korrik	217,155	217,159	100	229,763	231,123	101	221,361	259,938	117
Gusht	217,054	226,413	104	238,167	243,222	102	228,462	254,143	111
Shtator	210,533	219,381	104	328,510	327,868	100	230,272	229,149	100
Tetor	201,325	230,992	115	242,761	229,653	95	231,012	372,186	161
Nëntor	211,871	208,348	98	265,746	270,194	102	310,762	369,528	119
Dhjetor	229,313	277,881	121	234,070	335,870	143	299,247	370,418	124
Totali	2,476,508	2,568,877	104	2,915,021	3,019,836	104	2,969,112	3,521,865	119

Të dhënat: DDR, Punoi:KLSH

Faktorët që kanë ndikuar në realizim janë:

Për vitet 2022-2024 dy artikujt kryesorë që zënë peshën kryesore në të ardhurat e Degës Doganore janë: Softuerat e kompanive celulare, armatimet dhe pajisjet për forcat ushtarake dhe policore, aparatet telefonike dhe aksesorët e tyre, pasaportat dhe kartat e identitetit si dhe konfeksionet .

Nga auditimi i kryer lidhur me procesin e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që pritet të gjenerohen, konstatohet se Dega Doganore Rinas nuk përfshihet në këtë vendimmarrje, por plani sipas çdo muaji përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe është pikërisht ky autoritet që kryhen dhe ndjekjen e realizimit. Ky planifikim përcillet elektronikisht dhe pëson ndryshime të shpeshta edhe përgjatë muajit, të cilat ndjekin nivelin e realizimit. Pra, Dega Doganore nuk disponon një plan fillestar vjetor sipas çdo muaji, apo një informacion për metodologjinë e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që ndiqet nga DPD. Për këtë arsye nuk mund të kryhej një krahasim mes planit fillestar dhe atij të ndryshuar, dhe për sa kohë plani mujor pëson ndryshime të shpeshta, mbetet një faktor kryesor në finalizimin të

realizimit të të ardhurave doganore me mbi realizim apo me realizim pothuajse 100% të planit. Kontributi i DDK në planifikimin e tyre konsiston vetëm në paraqitjen e statistikave në nivel tepër sintetik dhe të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizim apo mosrealizim. Kjo në kundërshtim me Ligjin 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

III.2. Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim.

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në drejtimit e mëposhtme:

Gjendja e detyrimeve të subjekteve debitor, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim dhe në fund, kontabilizimi i tyre.

Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor.

Rregullshmërinë e dosjeve të borxhit.

Mbi procedurat e ndjekura për mallrat e sekuestruara apo konfiskuara për periudhën nën auditim 01.07.2022-31.12.2024.

Baza ligjore, e cila ka shërbyer si kriter vlerësimi:

Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

VKM nr.651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

Udhëzimi i DPD, nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganor edhe të akcizës”.

Urdhëri nr.5 datë 31.03.2016, “Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në Republikën e Shqipërisë.

Urdhëri nr.5 datë 12.01.2024, “Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Për auditimin e BD, nga ana e Grupit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Evidenca të BD, për gjithë periudhën korrik 2022 deri në dhjetor 2024;
- Vendimet e ekzekutimit të BD, për periudhën 2022-2024;
- Vendimet dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga DDR për vjeljen e BD;
- Kontabilizimi i borxhit doganor, Pasqyrat financiare, llogaria 468.

2. Auditimi i borxhit doganor, gjendja e detyrimeve të subjekteve debitor, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim të auditimit 01.07.2022 deri në datën 31.12.2024. Masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor për periudhën nën auditim.

2.1 Auditimi i borxhit doganor, Gjendja e detyrimeve të subjekteve debitor, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim të auditimit 01.07.2022 deri në datën 31.12.2024.

2.1.1 Periudha nga data 01.07.2022-31.12.2022.

Nga auditimi rezultoi se Dega e Doganës Rinas, në fillim të periudhës së auditimit 01.07.2022 paraqitet me një borxh doganor në vlerën 10,814,999 lekë, që i përket 17 rasteve dhe 12 subjekteve debitorë. Gjatë periudhës në vazhdim nga DDR janë marë 50 vendime me vlerë

totalë 6,478,829 lekë, të ndara në detyrim në vlerë 3,469,095 lekë dhe penalitet në vlerën 3,009,734 lekë. Gjatë periudhës korrik-dhjetor 2022 janë arkëtuar vendime në vlerën 8,618,785 lekë, të ndara në vlerën 2,321,461 lekë që i përkasin vendimeve përpara periudhës në auditim dhe në vlerën 6,297,324 lekë vendime të nxjerra gjatë periudhës nën auditim. Nga analizimi arkëtimeve të periudhës në auditim, rezulton se janë likuiduar 44 vendime në total 6,297,325 lekë, të ndara në 3,318,751 lekë detyrim dhe 2,978,573 leke penalitete të periudhës korrik-dhjetor 2022, ndërsa 4 vendimet e tjera në vlerën 181,544 lekë, të ndara në detyrim në vlerën 122,644 lekë dhe penalitet në vlerën 58,900 lekë nuk janë likuiduar dhe pasqyrohen në listën e debitorëve në dhjetor 2022. Gjatë kësaj periudhe nga ana e këtij sektori kemi një ulje të borxhit Borxhi në fundin e vitit 2022 e përfaqësuar nga 18 raste, të cilat do të analizohen sa më poshtë:

Tabela nr.1 Gjendja e borxhit, sipas muajve viti Korrik-Dhjetor 2022.

Në lekë

Muaji	Debitor nga fillimi muaji			Debitor të shtuar gjatë muajit			Debitor të shlyer gjatë muajit			Gjendja Debitor në fund të muajit		
	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë
Korrik	17	12	10,814,999	2	2	40,000	2	2	45,000	17	12	10,809,999
Gusht	17	12	10,809,999	8	8	296,789	5	4	2,430,100	20	16	8,676,688
Shtator	20	16	8,676,688	0	0	0	0	0	0	20	16	8,676,688
Tetor	20	16	8,676,688	0	0	0	0	0	0	20	16	8,676,688
Nëntor	20	16	8,676,688	30	29	5,988,852	30	28	2,871,216	20	17	11,794,324
Dhjetor	20	17	11,794,324	8	8	153,228	10	10	3,272,469	18	15	8,675,083

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Tabela nr.1.1 Borxhi doganor (Detyrim/gjoba/interesa) deri me datë 31.12.2022

Në lekë

Periudha	Raste	Detyrime	Gjoba	Interesa	Totali	% Principal	% Gjoba	% Interesa
2022	18	2,511,597	5,439,666	723,820	8,675,083	28	64	8

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Nga auditimi pranë DDR, ka rezultuar se është kryer kontabilizimi i borxhit doganor në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 03.12.20218, Kapitulli V “Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi”, përsa i përket strukturës së tij. Përlllogaritjet e detyrimeve doganore, janë kryer nga zyra Juridike/Borxhit Doganor, sipas tabelës së mëposhtme dhe të ndarë në, Borxh doganor të papaguar (detyrime import apo eksport), Penalitete, Kamatë vonesa;

Tabela nr.1.2 Borxhi doganor i kontabilizuar.

Në lekë

Periudha	Raste	Sektori i borxhit				Sektori i Financës	Diferenca
		Detyrime	Penalitet	Kamatëvonesa	Totali	Totali, D-468	
2022	18	2,511,597	5,439,666	723,820	8,675,083	11,776,551	(3,101,468)

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Nga auditimi konstatohet se diferenca në shumën 3,101,468 lekë midis zyrës së financës dhe zyrës së borxhit, të raportuar për vitin ushtrimor 2022, lidhet me vendimin nr.55 datë 01.11.2022 për subjektin “O.T” me NIPT- L...S, pasi nga ana zyrës së borxhit arkëtimi i këtij detyrimi është konstatuar si i kryer brenda vitit ushtrimor 2022, por faktikisht arkëtimi ka ardhur si pagesë në thesar në janar të vitit 2023. Kjo diferencë automatikisht është zeruar në janar 2023 edhe nga zyra e financës, dhe domosdoshmërisht dhe në fund të vitit 2023, duke sjellë një rakordim të plotë midis dy zyrave sa i përket vitit ushtrimor.

2.1.2 Periudha nga data 01.01.2023-31.12.2023.

Nga auditimi rezulton se Dega e Doganës Rinas, në fillim të periudhës 01.01.2023 paraqitet me një borxh doganor në vlerën 8,675,083 lekë që i përket 18 rasteve. Gjatë periudhës në vazhdim DDR ka marë 48 vendime me vlerë totalë 8,931,645 lekë, të ndara në detyrim në vlerë 6,710,467 lekë dhe penalitetet në vlerën 2,221,178 lekë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë arkëtuar 8,284,525 lekë, të ndara në vlerën 201,544 lekë vendime të nxjerra përpara periudhës në auditim dhe në vlerën 8,082,981 lekë vendime të nxjerra gjatë periudhës nën auditim. Nga analizimi i arkëtimeve të periudhës në auditim, rezulton se janë likuiduar 46 vendime në total 8,082,981 lekë, të ndara në 6,503,301 lekë detyrim dhe 1,579,680 leke penalitete të periudhës janar-dhjetor 2023, ndërsa 2 vendimet e tjera në vlerën 848,664 lekë, të ndara në detyrim në vlerën 207,166 lekë dhe penalitetet në vlerën 641,498 lekë nuk janë likuiduar dhe pasqyrohen në listën e debitorëve në dhjetor 2023. Deri në fund të vitit 2023 konstatohet një rritje të borxhit, e përfaqësuar nga 15 raste, të cilat analizohen sa më poshtë:

Tabela nr.2 Gjendja e borxhit, sipas muajve viti Janar-Dhjetor 2023.

Në lekë

Muaji	Debitor në fillim të muajit			Debitor të shtuar gjatë muajit			Debitor të shlyer gjatë muajit			Gjendja Debitor në fund të muajit		
	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë
Janar	18	15	8,675,083	7	7	540,595	6	6	470,592	19	16	8,745,086
Shkurt	19	16	8,745,086	4	4	1,174,762	7	7	1,368,509	16	13	8,551,339
Mars	16	13	8,551,339	0	0	0	1	1	20,000	15	12	8,531,339
Prill	15	12	8,531,339	8	8	844,858	8	8	844,858	15	12	8,531,339
Maj	15	12	8,531,339	6	6	150,000	7	7	170,000	14	11	8,511,339
Qershor	14	11	8,511,339	0	0	0	0	0	0	14	11	8,511,339
Korrik	14	11	8,511,339	1	1	10,832	1	1	10,832	14	11	8,511,339
Gusht	14	11	8,511,339	1	1	20000	1	1	20,000	14	11	8,511,339
Shtator	14	11	8,511,339	2	2	4123312	2	2	4123312	14	11	8,511,339
Tetor	14	11	8,511,339	8	7	372012	7	6	352012	15	12	8,531,339
Nëntor	15	12	8,531,339	6	6	1098596	5	5	287732	16	13	9,342,203
Dhjetor	16	13	9,342,203	5	5	596678	6	6	616678	15	12	9,322,203

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Tabela nr.2.1 Borxhi doganor (Detyrim/gjoba/interesa) deri me datë 31.12.2023

Në lekë

Periudha	Raste	Detyrime	Gjoba	Interesa	Totali	% Principal	% Gjoba	% Interesa
2023	16	2,588,060	6,010,323	723,820	9,322,203	28	64	8

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Nga auditimi pranë DDR, ka rezultuar se është kryer kontabilizimi i borxhit doganor në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 03.12.20218, Kapitulli V “Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi”, përsa i përket strukturës së tij. Përlllogaritjet e detyrimeve doganore, janë kryer nga zyra Juridike/Borxhit Doganor, sipas tabelës së mëposhtme dhe të ndarë në, Borxh doganor të papaguar (detyrime import apo eksport), Penalitete, Kamatë vonesa;

Tabela nr.2.2 Borxhi doganor i kontabilizuar.

Në lekë

Periudha	Raste	Sektori i borxhit				Sektori i Financës	Diferenca
		Detyrime	Penalitet	Kamatëvonesa	Totali	Totali, D-468	
2023	16	2,588,060	6,010,323	723,820	9,322,203	9,322,203	(0)

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

2.1.3 Periudha nga data 01.01.2024-31.12.2024.

Nga auditimi rezulton se Dega e Doganës Rinas, në fillim të periudhës 01.01.2024 paraqitet me një borxh doganor në vlerën 9,322,203 që i përket 16 rasteve . Gjatë periudhës në vazhdim nga DDR janë marë 42 vendime me vlerë totalë 12,437,491 lekë, të ndara në detyrim në vlerë 6,406,626 lekë, penalitetet në vlerën 6,406,626 lekë dhe kamatëvonesa 0 lekë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë arkëtuar 12,417,491 lekë, të ndara në vlerën 20,000 lekë vendime të nxjerra përpara periudhës në auditim dhe në vlerën 12.397,491 lekë vendime të nxjerra gjatë periudhës nën auditim. Nga analizimi arkëtimeve të periudhës në auditim, rezulton se janë likuiduar 3 vendime në total 10,817,383 lekë, të ndara në 5,326,545 lekë detyrim dhe 5,490,383 leke penalitete të periudhës janar-dhjetor 2024. Gjatë kësaj periudhe konstatohet një ulje të borxhit, i cili në fundin e vitit 2024 paraqitet i përfaqësuar nga 12 raste, të cilat do të analizohen sa më poshtë:

Tabela nr.3 Gjendja e borxhit, sipas muajve viti Janar-Dhjetor 2024

Në lekë

Muaji	Gjendja Debitor në fillim të muajit			Debitor/Raste të shtuara gjatë muajit+kamate vonesat			Debitor/Raste të pakësuara gjatë muajit (të plotë ose të pjesëshëm)			Gjendja Debitor në fund të muajit huma		
	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë	Raste	Debitor	Vlerë
Janar	15	12	9,322,203	9	9	3,550,349	9	9	3,550,349	15	12	9,322,203
Shkurt	15	12	9,322,203	2	2	35,604	1	1	15,604	16	13	9,342,203
Mars	16	13	9,342,203	3	3	259,544	3	3	259,544	16	13	9,342,203
Prill	16	13	9,342,203	3	3	141,004	3	3	134,224	16	13	9,348,983
Maj	16	13	9,348,983	6	6	3,118,122	7	7	3,144,902	15	12	9,322,203
Qershor	15	12	9,322,203	1	1	0	1	1	-	15	12	9,322,203
Korrik	15	12	9,322,203	4	4	1,999,800	4	4	80,000	15	12	11,242,003
Gusht	15	12	11,242,003	0	0	0	0	0	-	15	12	11,242,003
Shtator	15	12	11,242,003	2	2	264,724	2	2	264,724	15	12	11,242,003
Tetor	15	12	11,242,003	1	1	39,924	2	2	39,924	15	12	11,242,003
Nëntor	14	12	11,242,003	7	7	891,770	7	7	2,811,570	15	12	9,322,203
Dhjetor	16	13	9,322,203	6	5	2,136,650	6	5	2,136,650	15	12	9,322,203

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Tabela nr.3.1 Borxhi doganor (Detyrim/gjoha/interesa) deri me datë 31.12.2024

Në lekë

Periudha	Raste	Detyrime	Gjoha	Interesa	Totali	% Principal	% Gjoha	% Interesa
2024	15	2,588,060	6,010,323	723,820	9,322,203	28	64	8

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Nga auditimi pranë DDR, ka rezultuar se është kryer kontabilizimi i borxhit doganor në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 03.12.20218, Kapitulli V “Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi”, përsa i përket strukturës së tij. Përlllogaritjet e detyrimeve doganore, janë kryer nga zyra Juridike/Borxhit Doganor, sipas tabelës së mëposhtme dhe të ndarë në, Borxh doganor të papaguar (detyrime import apo eksport), Penalitete, Kamatë vonesa;

Tabela nr.3.2 Borxhi doganor i kontabilizuar.

Në lekë

Periudha	Raste	Sektori i borxhit				Sektori i Financës	Diferenca
		Detyrime	Penalitet	Kamatëvonesa	Totali	Totali, D-468	
2024	15	2,588,060	6,010,323	723,820	9,322,203	9,322,203	(0)

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

2.1.4 Detyrimet në proces ankimimi për periudhën 2022-2024.

Në fund të vitit 2024 në DDR rezultojnë 3 subjekte në proces ankimimi, të ndara në 6 vendime, konkretisht sipas tabelës së më poshtë:

Tabela nr.4 Lista e subjekteve në proces ankimimi.

Pala Paditëse	Pala e Paditur	Vendimi Nr. Datë D.D.R	Detyrim doganor (lekë)	Penalitet(lekë)	Paguar(lekë)	Vendimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Nr. Datë	Vendimi Gjykatës Administrative të Apelit.
ADF	DDR/DPD	Nr.73, nr.74, nr.75, nr.76,datë01.12.2021	1,312,350	2,724,700	-	Pranimin e kërkesës	Në Proces
OT	DDR/DPD	Nr.55 Prot, datë 18.10.2022	1,550,734	1,550,734	3,101,468	Gj. Adm. Shk. Pare Tirane me vendimin Nr.2339 (80-2023-2397), dt 23.10.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë.	Në Proces
AP	DDR/DPD	Nr.10,dt 28.02.2023	1,034,505	50,000	1,084,505	Proces	Në Proces

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditim këto dosje dhe u konstatua se:

-Subjekti “A.D.F” ka paraqitur ankimim kundër vendimit të Degës Doganorë Rinas nr.73, datë 01.12.2021, nr.74, datë 01.12.2021, nr.75, datë 01.12.2021, dhe vendimin nr.76, datë 01.12.2021 për detyrim shtesë dhe gjobë në vlerën 1,312,350 lekë detyrim dhe 2,724,700 lekë gjoba tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Në lidhje me plotësimin e kushteve të ankimit administrativ subjekti nuk ka likuiduar detyrimin si dhe nuk ka garantuar gjobat siç parashikon Kodi Doganor në dispozitën 282. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave pas përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur mospranim të ankimit me arsyetimin se nga subjekti nuk janë kryer pagesat për detyrimin doganor dhe nuk janë vendosur garanci për këto gjoba siç parashikon Kodi Doganor në dispozitën 282. Në lidhje me vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për vendimin nr.206/2 prot, datë 31.01.2022 është njoftuar subjekti A.D.Fsi dhe Dega Doganore Rinas.

Dega Doganës Rinas me shkresën nr.430 prot, datë 04.02.2022 ka nxjerre vendimin për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, gjithashtu është drejtuar më kërkesë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesën për lëshimin e urdhërit të Ekzekutimit me nr.460, datë 30.03.2022. Dega Doganës Rinas është drejtuar përsëri kësaj gjykate me kërkesë për ndreqje gabimi material dhe me vendimin nr.120, datë 09.11.2022 është pranuar kërkesa për rregullimin e këtij gabimi.

Më pas Dega Doganës Rinas me shkresën nr.430/1 prot., datë 30.11.2023 është drejtuar Zyres Përmbarimore Tiranë për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit (Titullit Ekzekutiv), mbështetur në vendimin nr.460, datë 30.03.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Subjekti ankues ka paraqitur kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kundërshtuar vendimet e nr.73, 74, 75, 76, nxjerra nga DDR. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.870 (861), datë 18.04.2023 ka vendosur: Pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative të vendimeve nr.73, 74, 75, 76. Brenda afatit ligjor DPD ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi dhe çështja ndodhet aktualisht për gjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ.

-Subjekti “A.P ShPK” ka paraqitur ankim kundër vendimit të Degës Doganorë Rinas nr.10 datë 28.02.2023 për detyrim shtesë në vlerën 1,034,505 lekë dhe gjobë në vlerën 50,000 lekë. Gjithashtu subjekti ka plotësuar kushtin administrativ duke likuiduar detyrimin dhe ndërkohë për gjobën ka vendosur garanci. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është shqyrtuar ankimi dhe në përfundim të shqyrtimit, pasi ka kryer verifikimin administrativ ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.10, datë 28.02.2023 të Degës Doganore Rinas dhe rrëzimin e kërkesës ankimore nr.4740 prot., datë 15.03.2023, të shoqërisë A.P ShPK. Në lidhje me vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është njoftuar subjekti A.P ShPK si dhe Degën Doganore Rinas. Subjekti më pas është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi dhe Gjykata në përfundim të gjykimit me vendimin

nr.1930 (80-2024-1940) ka vendosur: Rrëzimin e padisë së palës paditëse A.P ShPK si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Nga auditimi konstatohet se në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve të papaguara referuar nenit 95 e vijues të Kodit Doganor, është bërë kalimi nga llogaria 7115210 e gjobave të llogaria 4665100 e mjeteve në ruajtje, sepse në rast se çështjet që janë në ankim nuk rezultojnë në favor të Degës së Doganës Rinas, kjo e fundit është e detyruar t'i kthejë shumën e paguar subjektit përkatës. Kjo mund të realizohet në periudhat e ardhshme ushtrimore vetëm nga llogaria e mjeteve në ruajtje 4665100, si e vetmja llogari që mbartet nga viti në vit. Zyra e Financës ka mbajtur njëkohësisht dhe llogarinë 468 si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare (llogari aktiv) dhe llogarinë 4665100 si detyrim për t'i kthyer mjetet monetare subjekteve përkatëse, nëse finalizimi i procesit gjyqësor, është në favor të subjekteve (pra llogari detyrimi). Ndërkohë zyra e borxhit e ka hequr si debitor në momentin që subjekti ka likuiduar detyrimin dhe ka vendosur garanci për gjobën, qoftë kjo në llogarinë 7115210 (llogari gjobe), qoftë në llogarinë ekonomike 4665100 (llogari mjete në ruajtje).

-Subjekti "O.T" ka paraqitur ankim kundër vendimit të Degës Doganorë Rinas nr.55, datë 18.10.2022 për detyrim shtesë në vlerën 1,550,734 lekë dhe gjobë në vlerën 1,550,734 lekë. Gjithashtu subjekti ka plotësuar kushtin administrativ duke likuiduar detyrimin dhe ndërkohë për gjobën ka vendosur garanci. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është shqyrtuar ankimi dhe në përfundim të shqyrtimit, pasi ka kryer verifikimin administrativ ka vendosur, me vendimin nr.21168/1 prot., datë 30.01.2023, lënien në fuqi të vendimit nr.55, datë 18.10.2022 të Degës Doganore Rinas. Në lidhje me vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshme të Doganave është njoftuar subjektin A.P ShPK si dhe Degën Doganore Rinas. Pas këtij vendimi subjekti i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr.2339 (80-2023-2397) ka vendosur rrëzimin e kërkesës padisë së subjektit O.T si të pabazuar në prova dhe në ligj. Brenda afatit ligjor subjekti O.T ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe çështja është në proces.

Nga auditimi konstatohet se në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve të papaguara referuar nenit 95 e vijues të Kodit Doganor, është bërë kalimi nga llogaria 7115210 e gjobave të llogaria 4665100 e mjeteve në ruajtje, sepse në rast se çështjet që janë në ankim nuk rezultojnë në favor të Degës së Doganës Rinas, kjo e fundit është e detyruar t'i kthejë shumën e paguar subjektit përkatës. Kjo mund të realizohet në periudhat e ardhshme ushtrimore vetëm nga llogaria e mjeteve në ruajtje 4665100, si e vetmja llogari që mbartet nga viti në vit. Zyra e Financës ka mbajtur njëkohësisht dhe llogarinë 468 si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare (llogari aktiv) dhe llogarinë 4665100 si detyrim për t'i kthyer mjetet monetare subjekteve përkatëse, nëse finalizimi i procesit gjyqësor, është në favor të subjekteve (pra llogari detyrimi). Ndërkohë zyra e borxhit e ka hequr si debitor në momentin që subjekti ka likuiduar detyrimin dhe ka vendosur garanci për gjobën, qoftë kjo në llogarinë 7115210 (llogari gjobe), qoftë në llogarinë ekonomike 4665100 (llogari mjete në ruajtje).

Në përfundim, referuar të dhënave të mësipërme për periudhën objekt auditimi, Dega Doganore Rinas ka rezultuar me ulje të borxhit doganor, pasi në 01.07.2022 borxhi doganor paraqitet në vlerën 10,814,999 lekë, ndërsa në fund të vitit 31.12.2024 paraqitet në vlerën 9,322,203 lekë, konkretisht një ulje të borxhit në vlerën 1,492,796 lekë. Gjithashtu edhe numri i rasteve rezulton me trend të moderuar ulje, nga 17 subjekte debitor në fillim të periudhës 01.07.2022, me 12 subjekte debitor në përfundim të periudhës së audituar, pra 5 subjekte më pak.

Tabela nr.5“Vjetërsia e BD lekë, në Dhjetor 2024”

Në lekë

1-vit		2-vjet		3-Vjet		4-Vjet		Mbi 5 vjet	
Raste	Vlerë	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë
1	20,000	1	828,664	0	0	4	4,037,050	9	4,436,489

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

2.2.1 Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor 01.07.2022-31.12.2024,

Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës 01.07.2022-31.12.2024 rezultojnë në total 140 vendime me vlerë totale 27,847,965 lekë, nga të cilët 16,586,188 lekë detyrim, penalitete në vlerën 11,261,777 lekë. Nga ana e grupit auditimit u përzgjedhën për auditim 12 dosje (duke patur si kriter përzgjedhjeje vlerën e detyrimit) , për vlerësimin e masave të marra për vjelje e borxhit doganor si dhe mënyrën e zbatimit të procedurave të rikuperimit të borxhit doganor. Subjektet e përzgjedhura, pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.6 Lista e subjekteve të përzgjedhura, për masat e marra për vjelje e borxhit doganor.

Në lekë

Subjekti	NUIS	Viti	Detyrimi Doganor	Penalitete	Interesa	Vendim		njoftimi	
						Nr.	Dt	Nr	Dt
A.K	L...U	2022	180,051	180,051	0	48	01.11.2022	3089/1	01.11.2022
O.T	L...S	2022	1,550,734	1,550,734	0	55	01.11.2022	2662/1	01.11.2022
D.B	J...Q	2022	220,666	220,666	0	57	01.11.2022	3078/1	01.11.2022
XH.S	J...R	2022	303,759	303,759	0	70	23.11.2022	3770/1	23.11.2022
A.P	L...N	2023	1,034,505	50,000	0	10	28.02.2023	4139/1	28.02.2023
H.P	G...D	2023	331,776	331,776	0	18	27.04.2023	1089/2	27.04.2023
A.C	J...F	2023	4,103,312		0	28	12.09.2023	2575/1	12.09.2023
A.M	J...G	2023	207,166	621,498	0	42	16.11.2023	3300/1	16.11.2023
M.A	M...T	2023	267,075	267,075	0	44	05.12.2023	3527/1	05.12.2023
JT ALB	M...R	2024	1,682,812	1,682,812	0	9	25.01.2024	216/1	25.01.2024
DPSH	K...P	2024	1,432,361	1,432,361	0	21	24.05.2024	1522/1	24.05.2024
E.K	J...F	2024	969,900	969,900	0	26	02.07.2024	1825/1	02.07.2024

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Konkluzione:

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të subjekteve të cituara në tabelë, rezultojnë se 10 subjekte kanë likuiduar brenda afatit ligjor detyrimin dhe penaltetin. Përjashtim përbën subjekti E.K me Nuis J...F, i cili rezultojnë se ka likuiduar detyrimet dhe penaltetin jashtë afateve ligjore, konkretisht subjekti ka likuiduar vlerën 1,939,800 lekë të ndarë në detyrimin në vlerën 969,900 lekë dhe penaltetin e vendosur në vlerën 969,900 lekë me datë 10.12.2024. Gjithashtu, subjekti M.H me Nuis J...G me vlerë borxhit 828,664 lekë i ndarë në 207,166 lekë detyrim dhe 621,498 lekë penaltet, rezultojnë debitor në fund të vitit 2024.

-Nga auditimi i dosjes së subjektit **E.K me Nuis J...F** në lidhje me zbatimin e procedurave të ndjekura për vjeljen dhe rikuperimin me forcë të borxhit doganor, rezultojnë se vendimi nr.26 për shpalljen debitor është nxjerrë në datën 02.07.2024, ndërsa për këtë rast është konstatuar se nuk është nxjerrë VRFB, si dhe nuk është marrë asnjë masë për rikuperimin e borxhit doganor. Gjithashtu nga analizimi i pagesës së kryer si dhe rakordimin mbi kontabilizimin e detyrimeve të papaguara rezultojnë se nga ana e Juristit/Specialisti i Borxhit nuk janë përlllogaritur kamatëvonesat siç përcaktohet në ligjin nr.102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, si dhe në udhëzimin nr. 15, datë 03.12.2018 në kreun V. Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi tyre. Vlera e kamatëvonesës e cila nuk është përlllogaritur në këtë rast është në vlerën 17,889 lekë pasqyruar sipas tabelës.

Tabela nr. Mbi përlllogaritjen e kamatëvonesës për subjekti E.K.

Vlera detyrimit	Norma interesit vjetor	Ditët e vonesës	Vlera kamatëvonesës që duhej llogaritur për tu paguar.
969,900	5.10%	132	17,889

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe në kundërshtim me Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës”.

Efekti financiar të ardhura të munguara për këtë rast është në vlerën 17,889 lekë.

- Nga auditimi i dosjes së subjektit **M.H me Nuis J...G** në lidhje me zbatimin e procedurave të ndjekura për vjeljen dhe rikuperimin me forcë të borxhit doganor, rezulton se vendimi nr.42 për shpalljen debitor është nxjerrë në datën 16.11.2023, ndërsa për këtë rast është konstatuar se nuk është nxjerrë VRFB, si dhe nuk është marrë asnjë masë për rikuperimin e borxhit doganor. Gjithashtu nga analizimi i rastit si dhe rakordimin mbi kontabilizimin e detyrimeve të papaguara rezulton se nga ana e Juristit/Specialisti Borxhit nuk janë përlllogaritur kamatëvonesat siç përcaktohet në Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018 në kreun V. Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe në kundërshtim me Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018 Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

Tabela nr. Mbi përlllogaritjen e kamatëvonesës për subjekti M.H.

Vlera detyrimit	Norma interesit vjetore	Ditët e vonesës	Vlera kamatëvonesës që duhej llogaritur për tu paguar.
207,166	5.10%	410	11,635

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe në kundërshtim me Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës”

Efekti financiar të ardhura të munguara për këtë rast është në vlerën 11,635 lekë.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi 01.07.2022-31.12.2024 rezulton se nuk janë përlllogaritur kamatëvonesat siç përcaktohet në nenin 107 të ligjit nr.102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, si dhe në Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 në kreun V. Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi tyre për rastet e trajtuar më sipër në vlerën 29,524 lekë. Gjithashtu nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës, ngarkohet me përgjegjësi **z. A.S, me detyrë Jurist/Specialist Borxhi dhe z. L.M, me detyrë Kryetar i Degës Doganore Rinas.**

2.2.2 Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor të mbartur deri me datë 31.12.2024.

Subjekte debitor të mbartura dhe të shtuara në fund të vitit 2024, rezultojnë në total 13 subjekte të cilët përfaqësojnë 16 raste me vlerë borxhi doganor 9,342,203 lekë detyrime të papaguara. Nga zyra Juridike me qëllim uljen e borxhit doganor, deri në fund të vitit 2024 kanë dalë 10 VRFB me vlerë 8,473,539 lekë, 9 Urdhër Ekzekutimi me vlerë borxhi doganor 8,419,097 lekë, dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbartimit Shtetëror 9 subjekte me vlerë 8,419,097 lekë, ndërsa për 8 subjekte janë ndjekur masat shtrënguese në vijim, bllokimi llogarive bankare, vendosja e mase sigurimit ne ZRPP, vendosja e mase sigurimit ne DPSHTRR dhe bllokimin i

veprimeve në QKB në vlerën 4,382,047 lekë, Trajtuar më hollësisht në aneksin nr.VI, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për verifikim 3 subjekte me detyrime të papaguara në vlerën 8,246,313 lekë, të cilët përfaqësojnë 88 % të vlerës së borxhit doganor në Degën Doganore Rinas pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.8 “Mbi procedurat e zbatuara për rikuperimin me forcë të borxhit”, viti 2024 Në lekë

NR	Emri Subjektit	NUIS	Periudha e kontrolluar	Detyrimi Doganor	Penalitete	Interesa	Shuma totale	Shuma e paguar	Shuma për tu paguar
1	A.P	K.....G	2012	322,844	645,688	321,352	1,289,884	0	1,289,884
2	U.L	L.....L	2018	640,007	1,920,021	359,351	2,919,379	0	2,919,379
3	AD.F	J.....L	2021	1,312,350	2,724,700	0	4,037,050	0	4,037,050

Të dhënat: DDR, Punoi: KLSH

Konkluzione:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e subjekteve të përzgjedhura për auditim, në lidhje me zbatimin e procedurave të zbatuara për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, trajtuar rast pas rasti, rezultuan se janë marrë masa të plota administrative-ligjore parashikuar nga neni 95-116, si dhe neni 280 e vijues i Kodit Doganor për subjektin A.P me Nuis K.....G dhe për subjektin U.L Nuis L.....L.

Nga auditimi i dosjes së subjektit A.D.F Distributor me Nuis J....L mbi zbatimin e procedurave të zbatuara për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, rezulton se në këtë rast është konstatuar vonesë në nxjerrjen e VRFB, pasi 3 vendime të shpalljes debitor janë nxjerrë me datë 01.12.2021 dhe 1 vendim i shpalljes debitor është nxjerrë në datën 10.12.2021, ndërsa VRFB janë nxjerrë me datë 07.02.2022 jashtë afatit ligjor të parashikuar në Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës”.

Zyra Juridike në Degën Doganore Rinas pas marrjes dijeni për zbatimin e masave garantuese/rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, ka kërkuar në gjykatë lëshimi urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me datë 30.03.2022. Në datën 30.11.2022 zyra Juridike/Borxhit në Degën doganore Rinas i është drejtuar zyrës së Përmbarimit Shtetëror për marrjen e masave garantuese/ dhe ose rikuperimit me force të detyrimeve të papaguara me shkresën nr.430/1 prot., datë 30.11.2023 për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit (Titullit Ekzekutiv), mbështetur në vendimin nr.460, datë 30.03.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ndërsa nga vetë autoriteti doganor, përmes strukturës së zyrës Juridike/Borxhit nuk është marrë asnjë masa për rikuperimin me forcë të borxhit doganor. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe në kundërshtim me Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi 01.07.2022-31.12.2024 rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018 Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

2.2.3 Analizimi pasqyrave financiare në fillim të periudhës së auditimit, konkretisht analizimi llogarisë 468 debitor të ndryshëm si dhe kontabilizimi i borxhit doganor sipas Udhëzimeve nr.4, datë 07.04.2016 dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018, Kapitulli V “Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi”.

Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitor të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Degës Doganore Rinas për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Degës Doganore Rinas për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 90,139,640 lekë. Sektori borxhit pranë Degës Doganore Rinas në fund të vitit 2022 raporton se borxhit doganor është në vlerën 8,675,083 lekë. Nga analizimi konstatohet se kemi diferenca midis kontabilitetit dhe sektorit të borxhit në vlerën 81,464,557 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u kërkuan shpjegime në lidhje me këto diferenca, për të cilat nga ana e subjektit të audituar është raportuar se vlera prej 78,362,289 rezulton të jetë borxh doganor i trashëguar nga vitet e kaluara duke nisur që nga viti 2010, 2011, 2012,2013 e në vazhdim, në të cilin nuk janë pasqyruar shuarja e detyrime doganore të falura me ligjin nr. 33/2017 për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore; ndërsa për vlerën prej 3,101,468 lek (Pra diferencë në rritje nga viti 2021) Zyra e borxhit gabimisht ka vendosur vlerën e borxhit (detyrimin doganor dhe gjobën) të subjektit O.T në vlerën prej 3,101,468 sikur është paguar në Dhjetor 2022 kur sipas evidencës së të ardhurave gjithashtu dhe në Asycuda (llogaria parapaguese e detyrimit doganor) shfaqet e paguar në Janar 2023. Ky borxh i trashëguar vazhdon i pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit raportues në sistemin alpha web vit pas viti dhe në bilancet ligjore që mbyllet çdo vit konkretisht që nga bilanci i vitit 2016, 2017 dhe në vazhdim.

Arsyet se përse kanë lindur këto diferenca midis borxhit dhe kontabilitetit janë:

1-Llogaria 468 është trashëguar në programe financiare me gjendjet faktike të ruajtuara nga viti në vit. Ky rezulton të jetë një borxh i trashëguar që nga vitet më parë. Ky borxh vazhdon të jetë i pasqyruar në pasqyrat financiare nëpërmjet sistemit alpha Web vit pas viti, edhe në bilancet e pasqyruara që nga viti 2016 dhe në vijim.

2-Zyra e Borxhit në evidencën e tij ka reflektuar vetëm detyrimet e lindura nga masat administrative të degës ndërsa struktura e financës operon me alpha web.

3- Në programin alpha web kartelat e llogarive të të gjithë subjekteve që gjenden kanë të reflektuar të gjithë aktivitetin financiar të tyre përfshirë kohën e lëvizjeve financiare të tyre para fillimit të llogarisë së përqendruar në DPD të cilat janë të pa rakorduara me datën e fillimit të kësaj llogarie.

2.2.4 Verifikimi i dosjeve të borxhit doganor dhe akcizës, referuar Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, Kapitulli XV “Dokumentacioni për detyrimet e papaguara”.

Nga Grupi i auditimit, u shqyrtuan me zgjedhje 3 nga 12 dosje të borxhit doganor, kryesisht dosjet e debitorëve më të mëdhenj referuar udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018, Kapitulli XV “Dokumentacioni për detyrimet e papaguara” i cili ka përcaktuar se: *“Në përfundim të gjithë procedurës për evidentimin, kontabilizimin, njoftimin vjeljen dhe shuarjen e borxhit, dosja e Borxhit doganor/borxhit të akcizës dhe e detyrimeve që duhen paguar duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme”.*

Nga verifikimi mbi rregullshmërinë e dokumentacionit të administruar në dosjet e borxhit kanë rezultuar mangësi si më poshtë vijon:

- Asnjëra prej dosjeve nuk është shoqëruar me inventarin fizik në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Vendimin nr.4, datë 19.06.2017 të Këshillit të Lartë të Arkivave për miratimin e “Rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 4 dhe 8.

- Jo të gjitha dosjet janë plotësuar rregullisht me dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, Kapitulli XV “Dokumentacioni për detyrimet e papaguara” pasi në disa raste, trajtuar hollësisht në Tabelën “Mbi procedurat e zbatuara për rikuperimin me forcë të borxhit, viti 2024”, bashkangjitur procesverbalit, mungonin lajmërim marrjet për subjektet debitor, kërkesa për lëshimin e urdhërit ekzekutiv,

vendim për lëshimin e urdhrat ekzekutiv, kërkesa drejtuar përmbaruesit, kontrata e lidhur me përmbaruesit, gjithashtu në dosjet nuk administrohet informacioni dhe dokumentacioni mbi rikuperimin me forcë të borxhit, nga ana e Shoqërive Përmbarimore.

2.2.5 Mbi procedurat e ndjekura për mallrat e sekuestruara apo konfiskuara për periudhën nën auditim 01.07.2022-31.12.2024.

Nga auditimi ka rezultuar se Dega Doganore Rinas nuk rezulton të këtë mallra të sekuestruara apo të konfiskuara për periudhën në auditim, për rrjedhojë nga ana e Kryetarit të DDR, nuk janë nxjerrë urdhrat mbi marrjen e masave administrative, konfiskimin e mallrave, bërjen hyrje në magazinat e DDR, apo kryerjen e procedurave të mëtejshme për asgjësimin e tyre.

Për mangësitë e trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. A.S, me detyrë Jurist dhe specialist Borxhi dhe z. L.M, me detyrë Kryetar i Degës Doganore Rinas.

III. 3. Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori regjime/përrjashtime gjatë mbikëqyrjes doganore të regjimeve ekonomike për RPA dhe RLP.

Regjimi i magazinimit doganor lejon ruajtjen në një magazinë doganore: të mallrave jo shqiptare, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit ose masave të politikës tregtare; dhe të mallrave shqiptare, kur dispozitat në fuqi që rregullojnë fusha të veçanta, parashikojnë që vendosja e tyre në magazinat doganore kërkon zbatimin e masave që normalisht lidhen me eksportin e këtyre mallrave.

Lidhur me përputhshmërinë e procedurave të ndjekura për mbikëqyrjen e regjimit të magazinimit doganor auditimi u krye bazuar në:

1. Ligji Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
2. VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit 102/2014 Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar;
3. Urdhërit Nr.146 (7786/1), datë 07.05.2018: “Rregullore e brendshme e degëve doganore”.
4. Udhëzimi nr.7 , datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur, për 6 mujorin e dytë të vitit 2022, vitin 2023 dhe vitin 2024 nga kjo degë doganore sektori Cargo janë mbikëqyrur procedurat e kontrollit të mallrave të vendosura në ambientet e magazinimit të përkohshëm të miratuara për tre subjekte dhe procedurat e kontrollit të mallrave të vendosura në katër magazina doganore me qëllim verifikimi e lëvizjes së mallrave nga momenti i hyrjes në territorin shqiptar, formalitetet e vendosjes së mallrave nën regjim, deri në mbylljen e regjimit doganor.

IA Lidhur me mbikëqyrjen e Regjimit të Magazinimit Doganor

Gjatë periudhës nën auditim, kjo degë doganore, sektori Cargo, ka qenë mbikëqyrëse për veprimtaritë e katër Magazinave Doganore private të tipit C, dhe për të cilat janë paraqitur dosjet përkatëse dhe informacione për kontrollet e ushtruara nga doganierët mbikëqyrës të këtij sektori. Auditimi u fokusua në zbatimin e saktë në praktikë të procedurave doganore nga ky sektor lidhur me regjimin e magazinimit doganor. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se:

IA.1-Autorizimi për magazinë doganore nr.2626/10820, datë 21.09.2006, Ndryshim autorizimi me vendimin nr.14430/3 prot., datë 08.11.2010 të DPD, mbajtës i autorizimit shoqëria “A.B.A” SHA, me NUIS J.....L magazinë doganore private numër identifikimi **C002.**

Nga dokumentacioni i paraqitur për mbikëqyrjen e autorizimit gjatë vitit 2023, rezulton se janë kryer tre kontrolle fizike sipas informacioneve drejtuar kryetarit të degës doganore nr.1244 prot., datë 18.04.2023; nr.1885/1 prot., datë 11.07.2023 dhe nr.3636 prot., datë 13.12.2023. Për vitin 2024 është paraqitur dokumentacioni për 1 kontroll të kryer sipas informacionit nr.3039 prot., datë 04.10.2024.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur për konstatohet se nuk janë kryer kontrollet fizike çdo tre muaj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD.

I.A.2-Autorizimi për magazinë doganore nr.1800/2, datë 12.02.2019 i DPD mbajtës i autorizimit shoqëria “AVIG” SHA me NUIS K...O, magazinë doganore private numër identifikimi C94.

Për mbikëqyrjen e këtij autorizimi janë kryer këto kontrolle: gjatë vitit 2022 kontroll sipas shkresës Nr.2871 prot., datë 08.09.2022; gjatë vitit 2023 janë kryer kontrolle fizike sipas informacioneve drejtuar Kryetarit të degës doganore nr.463/1 prot., datë 20.02.2023; nr.1231 prot., datë 17.04.2023; nr.1961/1prot., datë 06.07.2023 dhe nr.3594 prot., datë 07.12.2023.

Për vitin 2024 është kryer një kontroll sipas informacionit nr.3038 prot., datë 07.10.2024.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur për konstatohet se nuk janë kryer kontrollet fizike çdo tre muaj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD. Gjithashtu, nga verifikimi i garancisë, konstatohet se vlefshmëria e saj është deri 07.02.2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD.

I.A.3-Autorizim për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor nr.10099/1, datë 16.06.2023, tipi magazinës magazinë doganore private numër identifikues magazinës C108, periudha kohore e vlefshmërisë pa afat, lëshuar nga DPD mbajtës i autorizimit shoqëria “T.G.A” SHPK, me NUIS M...Q.

Garanci datë 11.09.2024 afat 10.09.2025.

Për mbikëqyrjen e këtij autorizimi gjatë vitit 2024 janë kryer tre kontrolle fizike sipas informacioneve drejtuar Kryetarit të Degës Doganore nr.93 prot., datë 09.01.2024; nr.2015 prot., datë 03.07.2024 dhe nr.3310 prot., datë 25.10.2024.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur për konstatohet se nuk janë kryer kontrollet fizike çdo tre muaj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD. Gjithashtu është konstatuar mos mbajtje e regjistrave të sekretuar nga dogana. Sipas shkresës nr.3310 prot., datë 25.10.2024 është konstatuar se mbetet problem paraqitja në kohë reale e shitjeve, pra prodhimi i DAV EXP në doganë, kjo procedurë nuk ndiqet në mënyrë koherente nga subjekti duke sjellë anomali në përpunimin e deklaratave të eksportit dhe pasqyrimin të tyre në doganë. Gjithashtu dhe regjistri i hyrje daljeve sipas aneksit 5, të Dispozitave Zbatuese për mallrat e importi nga jashtë nuk mbahet në rregull.

Sipas pikës VI Detyrimet e administruesit të regjimit të magazinimit doganor, të Udhëzimit nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD, citohet: “IV. Detyrimet e Administruesit të regjimit të magazinimit doganor.1. Plotësimi i regjistrit të magazinimit doganor standard sipas modelit të aneksit 5 dhe 5/1 të cilin duhet ta sekretojë në degën doganore mbikëqyrëse. Mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas penalteteve të parashikuara nga Kodi Doganor, regjistri elektronik nuk mund ta zëvendësojë plotësimin e regjistrit tip”.

Konstatojmë se mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi, sipas shkresës nr.3310prot., datë 25.10.2024 megjithëse konsiderohet shkelje sipas nenit 252, pika g, të Kodit

Doganor, subjekti nuk është penalizuar sipas nenit 257 pika 1/b të Kodit Doganor në shumën 50,000 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD.

Për sa më sipër konstatohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, si penalitet në shumën 50,000 lekë.

I.A.4-Autorizim për magazinë doganore private “DUTY FREE SHOPS” nr.14046/3 lëshuar nga MFE datë 18.08.2021 numër identifikimi CDF002, mbajtës shoqëria “T.G.A” SHPK, me NUIS M...Q.

Garanci datë 28 Shkurt 2024 afat deri 26 Shkurt 2025.

Për vitin 2023 janë kryer dy kontrolle sipas informacionit nr.2535 prot., datë 24.08.2023 dhe nr.3672 prot., datë 20.12.2023.

Për mbikqyrjen e këtij autorizimi gjatë vitit 2024 janë kryer dy kontrolle fizike sipas informacioneve drejtuar Kryetarit të Degës Doganore nr.3346 prot., datë 25.07.2024; nr.3082 prot., datë 21.10.2024.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur për konstatohet se nuk janë kryer kontrollet fizike çdo tre muaj, në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” i DPD. Gjithashtu është konstatuar mos mbajtje e regjistrave të sekretuar nga dogana. Sipas shkresës nr.3346 prot., datë 25.07.2024 është konstatuar “mos mbajtja e regjistrave të sekretuar nga dogana”. Sipas pikës VI Detyrimet e administruesit të regjimit të magazinimit doganor, të Udhëzimit nr.7 , datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD, citohet : “IV. Detyrimet e Administruesit të regjimit të magazinimit doganor.1. Plotësimi i regjistrit të magazinimit doganor standard sipas modelit të aneksit 5 dhe 5/1 të cilin duhet ta sekretojë në degën doganore mbikëqyrëse. Mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas penalteteve të parashikuara nga Kodi Doganor, regjistri elektronik nuk mund ta zëvendësojë plotësimin e regjistrit tip”.

Konstatohet se mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi, sipas shkresës nr.3346 prot., datë 25.07.2024 megjithëse konsiderohet shkelje sipas nenit 252, pika g, të Kodit Doganor “Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: g) mosrespektimi nga mbajtësi i autorizimit apo mbajtësi i një regjimi i detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave që mbulohen nga regjimi i magazinimit doganor, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 215”, subjekti nuk është penalizuar sipas nenit 257 pika 1/b të Kodit Doganor “1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë .”

Për sa më sipër konstatohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, si penalitet në shumën 50,000 lekë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi doganierët mbikëqyrës së regjimit: A.B, J.K, E.Z, A.K.

I.B.Lidhur me mbikqyrjen e Magazinave të Përkohshme:

Në bazë të neni 16/pika 17 Kodit Doganor : “Magazinim i përkohshëm” është situata e mallrave joshqiptare të magazinuara përkohësisht nën mbikëqyrjen doganore në periudhën ndërmjet paraqitjes së tyre në doganë dhe vendosjes së tyre në një regjim doganor ose rieksporti. Gjatë periudhës nën auditim nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur, janë mbikëqyrrur tre regjime magazinimi të përkohshëm me autorizimet përkatëse:

I.B.1-Autorizimi për përdorimin e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm Nr.30592/1, datë 22.01.2019 lëshuar nga DPD, mbajtës autorizimi shoqëria “D.I.A.L”SHPK, me NUIS J...I, tipi i magazinës : magazinë e përkohshme, numri identifikues i magazinës MP1, periudha kohore e vlefshmërisë : pa afat. Garanci datë 25 Mars 2022, shuma e garancisë 8,000,000 (tetë milion) lekë, afati i garancisë deri në 31 Janar 2027.

I.B.2-Autorizimi për përdorimin e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm Nr.13772/1, datë 17.06.2015 lëshuar nga DPD, mbajtës autorizimi shoqëria “T.I.A”SHPK, me NUIS K....D , tipi i magazinës : magazinë e përkohshme, numri identifikues i magazinës MPR, periudha kohore e vlefshmërisë : pa afat. Garanci datë 30 Korrik 2024, shuma e garancisë 4,000,000 (katër milion) lekë, afati i garancisë deri në 30 Korrik 2027.

I.B.3-Autorizimi për përdorimin e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm Nr.22988/1, datë 02.02.2021 lëshuar nga DPD, mbajtës autorizimi shoqëria “T” SHPK, me NUIS K....I, tipi i magazinës: magazinë e përkohshme, numri identifikues i magazinës MP32, periudha kohore e vlefshmërisë: pa afat. Garanci datë 09 Nëntor 2020, shuma e garancisë 4,000,000 (katër milion) lekë, afati i garancisë deri në 8 Nëntor 2025.

Lidhur me procedurat e kontrollit të mallrave të vendosura në ambientet e magazinimit të përkohshëm të miratuara për disa subjekte , me qëllim verifikimi e lëvizjes së mallrave nga momenti i hyrjes në territorin shqiptar, deri në momentin e vendosjes në një regjim doganor, ose ri-eksportimin. Sipas përcaktimeve të nenit 139 të Kodit Doganor, afati i qëndrimit të mallrave në kushtet e magazinimit të përkohshëm është 90 ditë.

-Autorizimi për përdorimin e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm Nr.13772/1, datë 17.06.2015 lëshuar nga DPD, mbajtës autorizimi shoqëria “T.I.A” SHPK, me NUIS K...D. Nga dokumentacioni informacioni i paraqitur shkresa nr.429 prot., datë 07.02.2024 grupi i punës i përbërë nga A.B J.K dhe E.Z është paraqitur pranë operatorit (T.I.A) Autorizimi 13772/1, datë 17.06.2015 dhe ka kryer inventarin fizik në zbatim të urdhrit të Kryetarit të DDRinas nr122prot., datë 11.01.2024. Sipas këtij informacioni: “problem më evident i gjendjes së magazinës së TIA është evidentimi i mallrave të shpallur abandon. Për këtë duhet të merren masa nga administrata doganore për të bërë njoftimet pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit për ti transferuar në favor të tyre sipas ligjeve në fuqi”.

-Për operatorin “U.T” SHPK (UPS), Autorizimi nr.22988/1, datë 02.02.2021. Nga shkresa nr.1396 prot., datë 07.05.2024 informacion drejtuar Kryetarit të DDRinas në zbatim të urdhërit të brendshëm nr.1195 prot., datë 11.04.2024 për ngritjen e grupit të punës për kontrollin e gjendjes së mallrave duke përfshirë dhe gjendjen e mallrave abandon, citohet : “problem më evident i gjendjes së magazinës UPS është evidentimi i mallrave të shpallura abandon, u bë kontrolli fizik i tyre. Nga grupi i punës A.B, J.K, M.J, E.Z së doganës dhe përfaqësuesit e UPS duke mbajtur proces verbalet përkatëse për cdo ngarkesë. Duhet vazhduar procedura nga DDRinas pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit”.

-Për operatorin “D.I.A”LTD (TIA) Autorizim nr.30952, datë 22.01.2019. Në shkresën nr.574, datë 07.02.2024, informacion drejtuar Kryetarit të DDRinas në zbatim të urdhërit të brendshëm nr.259 prot., datë 24.01.2024 për ngritjen e grupit të punës i cili do të kontrollojë gjendjen e mallrave në magazinën e përkohshme DHL, citohet: “problem më evident i gjendjes së magazinës së DHL është evidentimi i mallrave të shpallura abandon, u bë kontrolli fizik i tyre. Nga grupi i punës së doganës A.B, J.K dhe E.Z dhe përfaqësuesit e DHL duke mbajtur proces verbalet përkatëse për çdo ngarkesë. Për këtë duhet të merren masa nga administrata doganore për të bërë njoftimet pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit për ti transferuar në favor të tyre sipas ligjeve në fuqi”.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se për periudhën nën auditim, është kryer nga një kontroll për çdo magazinë për verifikimin e mallrave që u ka kaluar afati 90 ditë, kontroll i ushtruar në vitin 2024. Konstatohet se për periudhën nën auditim për tre magazinat e përkohshme nga dokumentacioni i paraqitur, megjithëse kemi Urdhër të brendshëm të Kryetarit

të Degës Doganore drejtuar sektorit Cargo dhe Aposteriorit për të kontrolluar gjendjen e mallrave duke përfshirë dhe mallrat abandon për secilën magazinë deri në 31.12.2024 nuk ishte rregulluar situata.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur lidhur me mallrat që u ka kaluar afati 90 ditor konstatohen mungesa e kontroleve periodike dhe kemi ende mos rregullim të situatës së tyre, në kundërshtim me Ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Seksioni 3 Magazinimi i përkohshëm, nenet 134 deri 141; nenin 139 “Përfundimi i magazinimit të përkohshëm” : “Mallrat joshqiptare në magazinim të përkohshëm vendosen nën një regjim doganor ose rieksporthen brenda 90 ditëve”, nenin 137 “Kushtet dhe përgjegjësitë për magazinimin e përkohshëm të mallrave”: “1. Mallrat në magazinim të përkohshëm mund të magazinohen vetëm në ambiente magazinimi të përkohshme, në përputhje me nenin 138 ose, kur është e justifikueshme, në vende të tjera të caktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore. 2. Pa cenuar pikën 2, të nenit 125, mallrat në magazinim të përkohshëm janë objekt vetëm i atyre formave të trajtimit, të destinuara për të garantuar ruajtjen e tyre në një gjendje të pandryshueshme, pa i ndryshuar pamjen ose karakteristikat teknike. 3. Mbajtësi i autorizimit, i përcaktuar në nenin 138, ose personi, që magazinon mallrat në rastet kur ato magazinohen në vende të tjera, të caktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore, është përgjegjës: a) për të siguruar që mallrat në magazinim të përkohshëm nuk i shmangen mbikëqyrjes doganore; b) për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave në magazinë të përkohshme. 4. Kur, për çdo arsye, mallrat nuk mund të mbahen në magazinë të përkohshme, autoritetet doganore, pa vonesë, marrin të gjitha masat e nevojshme për të rregulluar situatën e mallrave, në përputhje me nenet 178, 179 dhe 180.”

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi A.B, J.K, E.Z dhe M.J.

II.Regjimi i lejimit të përkohshëm(RLP)

Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor shqiptar, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtuar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksporthen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor. Ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi. Afati gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm është 12 muaj, me një maksimum shtyrje deri në 10 vjet, me qëllim që të bëhet i mundur përmbushja e qëllimit të autorizimit. Regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit është një regjim ekonomik që mundëson lehtësimin dhe kryerjen e operacioneve të caktuara, nga subjektet Shqiptare duke përdorur mallrat jo shqiptarë me destinacion rieksportimit të tyre pas realizimit të qëllimit për të cilin ish autorizuar. Përdorimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit jepet për mallrat të cilat, ndërsa mbeten në pronësi të një personi të vendosur në një vend të huaj, nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara për dhënien e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit. Afatet janë të përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.

Baza ligjore: Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 202, 223 deri 226. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 533 deri 534, 649 deri 685.

Lidhur me mbikëqyrjen e RLP.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se: Dega Doganore Rinas funksionon si zyrë hyrëse dhe dalëse e mallrave, miraton Autorizime për Lejim të përkohshëm me përjashtim të plotë. Për periudhën në auditim janë lëshuar 44 autorizime, nga këto janë të mbyllura 30

autorizime brenda afateve të përcaktuara dhe janë në proces 14 autorizime. Janë aprovuar 11 shtyrje të afateve janë vendosur 3 penaltete për tejkalim afati.

Konkretisht për 6 mujorin e dytë të vitit 2022 janë lëshuar 5 autorizime RLP, është në proces deri në përfundim të afateve të përcaktuara një autorizim. Për vitin 2023 janë lëshuar 20 autorizime RLP, janë mbyllur 17 dhe tre prej tyre janë në proces deri në përfundim të afatit të shtyrë të vlefshmërisë prej 360 ditë. Për vitin 2024 janë lëshuar 19 autorizime RLP prej tyre 9 janë mbyllur dhe 10 janë në proces.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga auditimi për procedurat e ndjekura për mbikëqyrjen e këtyre regjimeve konstatohet moskryerje të kontrolleve të regjimeve lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre, në kundërshtim me neni 194 të Kodit Doganor, “Regjistrimet.”

III.Regjimi Përpunimit Aktiv (RPA)

Regjimi i përpunimit është një regjim doganor i cili lejon mallrat joshqiptare dhe shqiptare të përdoren në territorin doganor shqiptar, në një ose më shumë operacione përpunimi, të destinuara për t'u riekportuar nga ky territor doganor në formën e produkteve kompensuese, pa iu nënshtruar: **a)** detyrimit të importit; **b)** pagesave të tjera, sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse në fuqi; **c)** masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Regjimi i Përpunimit Aktiv ka në thelb eksportimin e punës, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë ekonomike që në mënyrë direkte bëjnë transformim të thjeshtë apo përfundimtar në mallra të gatshëm, për t'u përdorur si produkte në operacione të tjera përpunimi, montimi, apo për konsum. Gjithashtu, ky regjim jepet dhe për mallrat e destinuara për t'u nënshtruar operacioneve që garantojnë përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin e tyre për qarkullim të lirë; Përdorimi i këtij regjimi doganor ekonomik kushtëzohet nga lëshimi i autorizimit nga autoritetet doganore kompetente.

Baza ligjore: Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 202, 228 deri 231. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 529 deri 565, 687 deri 690. Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

Për periudhën nën auditim sipas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur kjo degë doganore është mbikëqyrëse e një autorizimi për Regjimin e Përpunimit Aktiv(RPA) sipas Autorizimit të lëshuar nga DPD AL31745/1, datë 16.05.2024, periudha kohore e vlefshmërisë 12 muaj, mbajtës i autorizimit shoqëria “I2I-145 A.M” SHPK, me NUIS M....E. Gjatë kësaj periudhe subjekti ka kryer 36 importe dhe 0 eksporte.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur konstatohet mangësi në procedurat për mbikëqyrjen e regjimit dhe kontrollet ,në kundërshtim me pikën XIII . Mbikëqyrja e regjimit, me pikën XV.Detyrimet e doganierit mbikëqyrës të Udhëzimit nr.4, datë 28.09.2018”Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”. Mangësi si moskryerje të kontrolleve dokumentare apo fizike të regjimit dhe mangësi në përmbajtjen e dosjes së regjimit, mungesë të raporteve për cdo kontroll të kryer apo akt rakordimet e mbajtura, në kundërshtim me Kodin Doganor, Neni 194 Regjistrimet 1. *Përveç regjimit të transitit ose kur parashikohet ndryshe, mbajtësi i autorizimit, mbajtësi i regjimit dhe të gjithë personat e tjerë që kryejnë një aktivitet që përfshin magazinim, punimin ose përpunimin e mallrave, apo shitjen a blerjen e mallrave në zona të lira, mbajnë regjistrimet e duhura në një formë të miratuar nga autoritetet doganore. Regjistrimet përmbajnë informacione dhe të dhëna, të cilat u mundësojnë autoriteteve doganore të mbikëqyrin regjimet në fjalë, në veçanti lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre.*”

Për sa më sipër Përgjegjës është doganieri i Degës Doganore Rinas, mbikëqyrës i regjimeve doganore RLP dhe RPA: F.L.

III.4. Auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklarimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni tregtar me përzgjedhje i praktikave doganore të importit për periudhën nën auditim të administruara nga Dega Doganore Rinas.

2. Të dhënat elektronike të zhdoganimeve të kryera të siguruara nga sistemi elektronik Asycuda World.

Periudha nën auditim sipas programit të auditimit është 06.2022-12.2024, por duke marrë në konsideratë se 6 muhori i dytë i vitit 2022 i Degës Doganore Rinas është trajtuar nga auditimi i ushtruar në DPD, kjo periudhë nuk është trajtuar në këtë fazë të auditimit.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave doganore IM4, kryesisht me origjinë NEU, por edhe EU për mallra të deklaruar, çmimi për njësi i të cilave rezulton dukshëm më i ulët krahasuar me çmimin e mallrave të njëjtë apo identik të importuar të deklaruar dhe transaktuar; e publikuar në tregje; të publikuar në bursë; si dhe të dhënat e miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të publikuara në faqen zyrtare të DPD, rezulton se nga ana e sektorit operacional pranë degëve doganore, Sektorit të Vlerësimit Doganor në Qendër (SQV), si dhe nga ana e Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO), për importet e mallrave nga disa subjekte, pranimi i transaksionit nuk ka qenë i justifikuar pasi referuar në pikën 7 të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, me qëllim standardizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë, nuk është bërë një **analizë** e thelluar, sepse:

së pari, “Vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuar me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit”, ku nga verifikimi në sistemin ORACLE, rezulton se çmimi për të njëjtin artikull, nga e njëjta origjinë, nga i njëjti eksportues për të njëjtin importues paraqitet i ndryshëm;

së dyti, “Vlerat e mallrave të dërguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si të dhëna të disponueshme etj”, ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin ORACLE, krahasuar me çmimet e publikuara në faqen zyrtare të DPD dhe të miratuara nga komisioni Add-Hoc pranë Ministrisë së Financave, janë shumë të ulëta;

së treti, “Vlera e produktit nuk mund të jete me e ulet se vlera e lendes së pare me te cilën është prodhuar”, ku nga verifikimi rezulton se çmimet e deklaruara dhe transaktuara të artikujve në sistemin ORACLE, në disa raste janë nën çmimin e lëndës së parë;

së katërti, “Vendi i origjinës me risk: Azisë, Lindjes së Largët, Vendeve Arabe, Zonave të Lira (zona off-shore), Amerika Latine”, ku nga verifikimi rezulton se janë trajtuar me transaksion mallrat e importuar nga këto vende, të cilat përcaktohen me risk të lartë me të cilat administrate doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi;

së pesti, “fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi, pra vendi i origjinës ndryshon nga vendi ku lëvrohet malli”, rezulton se nga verifikimi, transaksioni është kryer nga kompani me seli të ndryshme nga vendi i origjinës dhe dërgues i mallit;

së gjashti, “Kontrata me firmën shitëse, përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme në vlerë”, rezulton se nga verifikimi, për importet **nuk rezulton** kontratë bashkëngjitur praktikave doganore me firmën shitëse;

së shtati, në asnjë rast nuk është bërë asnjë investigim lidhur me verifikimin e faturave të deklaruara apo verifikim aposterior nga grup i përbashkët lidhur me çmimin e produkteve në

treg;

Nga auditimi rezultojnë rivlerësime mallrash për deklarime doganore për të cilat dokumentacioni justifikues nuk përmbush kriteret e trajtimit të këtyre deklarimeve sipas deklarimit të transaksionit, dhe për të cilat nga administrata doganore duhej të ishin marrë në konsideratë aplikimi i metodave të tjera alternative të vlerësimit doganor me impakt negativ në të ardhurat doganore dhe të ardhurat në Buxhetin e Shtetit, për të cilat subjektet deklarues të mallit të cilët kanë kryer procedura zhdoganimi, duhet të arkëtojnë të ardhurat doganore të munguara.

Sa më poshtë edhe rastet konkrete të cilat rezultojnë si gjetje dhe konstatime për vitin 2023 dhe 2024:

Në lidhje me procedurat e auditimit të procedurave doganore të ndjekura për vlerësimin doganor të mallrave të deklaruara sipas Kapitujve të Nomenklaturës së Mallrave në RSH, konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 **Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë** dhe shpjegimeve, pasi janë evidentuar trajtime dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Sesionit të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 *“Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”*, që lidhen me vlerësimin doganor. Konkretisht trajtime jo të bazuara sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 4.2 sipas metodës 2 shprehur sipas *“Vlerës se transaksionit e mallrave identike”* dhe pikën 4.6 sipas metodës 6 bazuar në të *“Dhënat e Disponueshme në RSH”* dhe pikës 5 *“Rregullimet”* dhe pikës 6 *“Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore”* sipas shpjegimeve të pikës 6/b/c/d dhe pikës 7 *“Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor”* sipas indikatorëve bazuar në çmime të ndryshme të deklaruara për të njëjtin produkt nga furnizues ose origjina të ngjashme, zona ofshore, përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme, mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje reciproke me Autoritet Doganor Shqiptarë, pagesat nuk bëhen direkt me furnizuesin, si dhe sipas pikës 8 *“Dokumentacioni Shtese”* sipas pikës 8/a/dh/ii/iii/vii/f dhe pikës 11 *“Përdorimi i Databasit të Vlerësimit”* bazuar në pikën 10/c. Konstatohet se dokumentacioni tregtar bashkangjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit dhe nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.

Mbi rastet e vlerësimit doganor të mallrave

1. Lidhur me formularin mbi rivlerësimin doganor konstatohet se nuk janë plotësuar pika 3 shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit shoqërues dhe pika 4 vendimmarrja, argumentimi sa me i plotë për procesin dhe mënyrën e vlerësimit doganor, veprime këto në kundërshtim me udhëzimin nr.05, datë 26.01.2018 *“Mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit të kontrollit aposterio operativ”*.

2. Nga auditimi konstatohet se ka mos përfshirje në vlerën për qëllime doganore të mallrave me skonto. Kjo është konstatuar në importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin *“12. Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia”*, të NKM, me origjinë EU/NEU. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë përpunuar 275 deklarata me vlerë të deklaruar 603,796,236 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditim 30 deklarata të përpunuara me vlerë 303,979,488 lekë ose në % 50 e vlerës për qëllime doganore, të pasqyruara në **Tabela nr. 2**, në aneksin nr.VI, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar

Nga auditimi rezulton se për 8 deklarata të përpunuara kemi mangësi në procedurat e ndjekura për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore, pasi në këto deklarata nuk janë përfshirë mallrat me skonto, (shiko vlerësimin në deklaratën nr.R20573 datë 03.07.2023).

Konkretisht nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të parashikuara në nenet 66-70 të Kodit Doganor si dhe udhëzimit nr. 3 datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”. Si dhe nga analizimi i këtyre rasteve kemi : Mosrespektim nga personi, që depoziton deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes dhe deklaratën e rieksporitit ose njoftimin e rieksporitit, i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë, njoftim apo aplikim, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 23. Si dhe ndryshime në vlerë të mallrave të zhdoganuara. Sipas nenin 66, Metoda e vlerësimit doganor bazuar në vlerën e transaksionit 1. Baza kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet, kur është e nevojshme. 2. Çmimi realisht i paguar apo që duhet paguar është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi të shitësi ose nga blerësi të një palë e tretë në përfitim të shitësit për mallrat e importuara dhe përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë si kusht për shitjen e mallrave të importuara.

Sipas Nenit 251 Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive: 1. Për qëllime të këtij neni, me kundërvajtje me përgjegjësi objektive kuptohen kundërvajtjet, për të cilat nuk kërkohet të provohet elementi faj, duke pasur parasysh karakterin objektiv të detyrimeve të përfshira dhe faktin që personat, të cilët kanë përgjegjësinë që t’i respektojnë nuk mund të justifikohen me padijeninë për ekzistencën e tyre, si dhe karakterin e tyre detyrues. 2. Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive:

Neni 70 Metoda dytësore për vlerësimin doganor 1. Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 66, ajo përcaktohet duke ndjekur, sipas radhës, procedurën e përmendur nga shkronja “a” deri në “ç”, të pikës 2, të këtij neni, duke u ndalur në të parën shkronjë, sipas së cilës mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave. Radha e zbatimit të shkronjave “c” dhe “ç” këmbëhet nëse këtë e kërkon deklaruesi. 2. Vlera doganore, sipas pikës 1, është: a) vlera e transaksionit e mallrave identike, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen; b) vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen; c) vlera e bazuar në çmimin për njësi, me të cilën mallrat e importuara ose mallrat identike apo të ngjashme, që u korrespondojnë mallrave të importuara, u janë shitur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në sasinë më të madhe të përgjithshme, personave, të cilët nuk kanë lidhje me shitësit;

1.Neni 256 “Sanksionet për kundërvajtjet me përgjegjësi objektive 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet doganore, të përcaktuara në nenin 251, duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.2 “Lista e deklaratave të cilat kanë mangësi në procedurat e ndjekura vitin 2023”

Subjekti	NUIS	Agjensia Doganore	Color	Nr Dek	Datë	Vlera Deklarates	Vlera saktë e deklaratës	Diferenca në Euro	Diferenca në lekë	Detyrimi (12.2%)	Penalitet	Kursi Këmbimit
A.SA	K....P	J009	Jeshil	43604	29.12.2023	9,084,069	9,306,255	2,180	222,186	27,107	27,107	101.92
A..	K....E	J015	Jeshil	38819	24.11.2023	20,070,544	20,174,722	987	104,178	12,710	12,710	105.55
A..	K....E	J015	Jeshil	22843	20.07.2023	7,074,002	7,130,947	535	56,945	6,947	6,947	106.44
A.A	L....O	J009	Jeshil	38995	25.11.2023	7,070,305	9,414,571	22,210	2,344,266	286,000	286,000	105.55
A.B	J...d	J009	Jeshil	17250	05.06.2023	6,758,124	8,579,936	16,395	1,821,812	222,261	222,261	111.12
E.G	K...P	J009	Jeshil	30908	26.09.2023	6,162,484	6,353,366	1,764	190,882	23,288	23,288	108.21
LS	J....J	J125	Jeshil	11884	19.04.2023	6,067,541	8,046,452	17,480	1,978,911	241,427	241,427	113.21

Burimi: nxjerrë nga sistemi ASYCUDA, punuar nga grupi i KLSH.

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në Kapitullin “12. *Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia*”, të NKM, me origjinë EU/NEU rezulton **1,639,480** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër konstatohet *se* nuk janë përfshirë për qëllime doganore mallrat me skonto, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Doganor nenet 66-70 dhe 251 të këtij kodi.

Përgjegjës sipas neneve 66-70 dhe 251 të Kodit Doganor, udhëzimit . 3 datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” dhe sipas udhëzimit nr.5 datë 26.01.2018 mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit aposterior operativ pika IV, procedurat që ndiqen nga SKAO. Ndërsa në praktikën R.38995 datë 25.11.2023 janë përgjegjës A.H dhe J.ç. Për praktikën R.17250 datë 05.06.2023 është përgjegjës N.H.

Mbi rastet e vlerësimit doganor të mallrave

Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin “12. *Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia*”, të NKM, me origjinë EU/NEU, rezulton se gjatë vitit 2024 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë përpunuar 279 deklarata me vlerë të deklaruar 559,180,777 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditim 40 deklarata të përpunuara me vlerë 314,063,407 lekë ose në % 56 e vlerës për qëllime doganore, të pasqyruara në tabelën nr.3, pasqyruar në aneksin VI, bashkëlidhur Raportit Përfundimëtar.

Nga auditimi rezulton se për 5 deklarata të përpunuara konstatohen sërish mangësi në procedurat e ndjekura për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore, pasi në këto deklarata nuk janë përfshirë mallrat me skonto:

Tabela nr.4 “Lista e deklaratave të cilat kanë mangësi në procedurat e ndjekura vitin 2024

Subjekti	NUIS	Agjensia Doganore	Color	Nr Dek	Datë	Vlera Deklarates	Vlera saktë e deklaratës	Diferenca në Euro	Diferenca në lekë	Detyrimi (12.2%)	Penalitet	Kursi Këmbimit
A.SA	K.....P	J009	Jeshil	14500	24.04.2024	10,472,166	10,747,858	2,680	275,692	33,634	33,634	102.87
A.SA	K.....P	J009	Jeshil	41948	01.11.2024	10,018,241	10,089,355	720	71,114	8,676	8,676	98.77
E.G	K...P	J009	Jeshil	40209	21.10.2024	5,606,679	6,228,993	6300	622,314	75,922	75,922	98.78
A.B	J...D	J009	Jeshil	9710	16.03.2024	6,131,588	7,977,826	17,754	1,846,238	225,241	225,241	103.99
A.B	J...D	J009	Jeshil	10872	26.03.2024	6,124,783	6,699,536	5,527	574,753	70,120	70,120	103.99

Burimi: nxjerrë nga sistemi ASYCUDA, punuar nga grupi i KLSH.

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në Kapitullin “12. *Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia*”, të NKM, me origjinë EU/NEU rezulton **827,186** lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Përgjegjës sipas neneve 66-70 dhe 251 të Kodit Doganor, udhëzimit . 3 datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” dhe sipas udhëzimit nr.5 datë 26.01.2018 mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit aposterior operativ pika IV, procedurat që ndiqen nga SKAO. Për praktikën R.9710 datë 16.03.2024 janë përgjegjës Z. R.B dhe Z. E.D. Ndërsa në praktikën R.10872 datë 26.03.2024 është përgjegjës Z. S.T.

Mbi rastet e vlerësimit doganor të mallrave celularë për vitin 2023.

Lidhur me importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones të NKM, me origjinë EU/NEU, nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë përpunuar 718 deklaratat me vlerë doganore të deklaruara 1,141,289,708 lekë.

Nga ana e grupit të auditimit janë audituar 150 deklaratat me vlerë 915,675,740 ose 80% e vlerës se e deklaratave të deklaruara. Nga sektori i vlerësimit në qendër (SVQ) dhe sektori kontrollit aposterior operativ (SKAO) u konstatua se metoda e aplikuar nuk është e justifikuar, duke mbajtur në konsideratë dokumentacionin praktikave doganore, pasi për të njëjtin artikull kemi qëndrime të ndryshme lidhur me vlerësimin doganorë. Deklaratat të cilat dalin me diferenca janë trajtuar rast pas rasti si më poshtë.

1. Deklarata R.27239 datë 28.08.2023: nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin samsung galaxy S23 ultra për sasinë 30 copë është deklaruar 465.5\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë, për artikullin playstation 70 copë është deklaruar me 100\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.21580 datë 11.07.2023 referuar për rivlerësim, vlerësimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik, ku vlera është samsung galaxy s23 ultra deklaruar 615.5\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë, ndërsa për artikullin Playstation është deklaruar në 283.5\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së rivlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferenca në të 2 produktet të cilat do të pasqyrohen sipas tabelës.

Tabela nr.5

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
M.L	M.....T	Samsung ultra S23	30	46,307.94	1,389,238.2	61,329	1,839,883	450,644	90,129
M.L	M.....T	Playstation	70	9,948	696,360	28,203	1,974,181	1,277,821	255,564

Përlllogaritja e diferencave në vlerësimin doganor në praktikën doganore për deklarime të mallrave në Kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones, të NKM, me origjinë EU/NEU rezulton me detyrim të munguar në shumën **345,693 lekë**, e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. A.B me detyrë doganier në DPD dhe Z. A.J me detyrë doganier në DPD.

2. Deklarata R.39638 datë 04.12.2023 nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi 12 për sasinë 500 copë është deklaruar 31\$ për copë, Xiaomi Redmi Note 12 pro për sasinë 30 copë janë deklaruar në vlerën 41\$ për copë, për Xiaomi Redmi Note 12 për sasinë 50 copë janë deklaruar 39\$ për copë, samsung A04E për sasinë 200 copë janë deklaruar 32\$ për copë dhe tablet për sasinë 150 copë deklaruar me 20\$ copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 93.9 lekë.

Krahasuar me deklaratën me nr.R.27239 datë 28.08.2023 dhe deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për artikullin Xiaomi Redmi 12 është deklaruar 105\$ për copë, Xiaomi Redmi Note 12 Pro janë deklaruar në vlerën 122.5\$ për copë, për Xiaomi Redmi Note 12 janë deklaruar 105.5\$ për copë, samsung A04E janë deklaruar 65.8\$ për copë dhe tablet deklaruar me 66.5\$ copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 93.9 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës:

Tabela nr.6

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklarates	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklarates	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Xiaomi redmi 12	500	2910.9	1455450	9,860	4,929,750	3,474,300	694,860
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12 pro	30	3849.9	115497	11,503	345,083	229,586	45,917
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12	50	3662.1	183105	9,906	495,323	312,218	62,444
J.R	L....P	Samsung A04E	200	3004.8	600960	6,179	1,235,724	634,764	126,953
J.R	L....P	Tablets	150	1878	281700	6,244	936,653	654,953	130,991

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones**, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton kemi detyrim të munguar në shumën **1,061,164 Lekë** e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit. *Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. A.H me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. E.D me detyrë përgjegjës turni në SVQ.*

3. Deklarata R.7042 datë 07.03.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për t'u përdorur. Nga verifikimi i deklarates së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Mini accessories për sasinë 2000 copë është deklaruar 0.1\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.96 lekë. Krahasuar me deklaratën e këtij subjekti çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat për këtë artikullin është vlerësuar dhe pranuar me 2\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.96 lekë. Nga krahasimi i deklarates së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.7

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklarates	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklarates	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Mini Accessories	2,000	10.843	21,686	217	433,720	412,034	82,407

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones**, të NKM, me origjinë EU/NEU rezulton **82,407 lekë**, e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Z. M.K me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. E.D me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

4. Deklarata R.11879 datë 19.04.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për t'u përdorur. Nga verifikimi i deklarates së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Mini accessories për sasinë 3,815 copë është deklaruar 0.1\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.96 lekë. Krahasuar me deklaratën e këtij subjekti çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat për këtë artikullin është vlerësuar dhe pranuar me 2\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.96 lekë. Nga krahasimi i deklarates së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.8

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Mini Accessories	3,815	10.396	39,661	207.92	793,214.8	753,554	150,711

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave ne Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones, të NKM, me origjinë EU/NEU, rezulton **150,711 lekë** e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. O.H me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. N.H me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

5.Deklarata R.35227 datë 30.10.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna te besueshme për t'u përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi 12 për sasinë 180 copë është deklaruar 32\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 100.480 lekë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 Pro për sasinë 30 copë është deklaruar 41.5\$, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 për sasinë 30 copë është deklaruar 41\$ për copë, artikullin Samsung A04E për sasinë 150 copë është deklaruar 33\$ për copë, artikullin Samsung A04 për sasinë 100 copë është deklaruar 32\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 100.480 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.27239 datë 28.08.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë artikullin Xiaomi Redmi 12 është deklaruar 105\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 Pro është deklaruar 122.5\$, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 është deklaruar 105.5\$ për copë, artikullin Samsung A04E është deklaruar 65.8\$ për copë, artikullin Samsung A04 është deklaruar 48.3\$. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 100.48 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.9

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Xiaomi redmi 12	180	3,215.36	578,764.8	10,550	1,899,072	1,320,307	264,061
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12 pro	30	4,169.92	125,097.6	12,309	369,264	244,166	48,833
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12	30	4,119.68	123,590.4	10,601	318,019	194,429	38,886
J.R	L....P	Samsung A04E	150	3,315.84	497,376	6,612	991,738	494,362	98,872
J.R	L....P	Samsung A04	100	3,215.36	321,536	4,853	485,318	163,782	32,756

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave ne Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **483,409 Lekë** e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. B.K me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. S.T me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

6.Deklarata R.28357 datë 06.09.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna te besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi 12 për sasinë 50 copë është deklaruar 35\$ për copë llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 97,061 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.27239

datë 28.08.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë artikullin Xiaomi Redmi 12 është deklaruar 105\$ për copë, llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 97,061 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.10

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Xiaomi redmi 12	50	3397	169,856.75	10,191	509,570	339,714	67,943

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave ne Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 *Smartphones*, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **67,943** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. E.K me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. N.H me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

7. Deklarata R.37530 datë 15.11.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 për sasinë 50 copë është deklaruar 41\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 Pro për sasinë 30 copë është deklaruar 42\$, artikullin Xiaomi Redmi 12 për sasinë 600 copë është deklaruar 33\$ për copë, artikullin Samsung A04E për sasinë 200 copë është deklaruar 33\$ për copë, artikullin Samsung A04 për sasinë 450 copë është deklaruar 32\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.27239 datë 28.08.2023 dhe deklaratën R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë artikullin Xiaomi Redmi Note 12 është deklaruar 105.5\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 Pro është deklaruar 122\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi 12 është deklaruar 105\$ për copë, artikullin Samsung A04E është deklaruar 65.8\$ për copë, artikullin Samsung A04 është deklaruar 48.3\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 99 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.11

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12	50	3,215.36	578,764.8	10,550	1,899,072	1,320,307	264,061
J.R	L....P	Xiaomi redmi note 12 pro	30	4,169.92	125,097.6	12,309	369,264	244,166	48,833
J.R	L....P	Xiaomi redmi 12	600	4,119.68	123,590.4	10,601	318,019	194,429	38,886
J.R	L....P	Samsung A04E	200	3,315.84	497,376	6,612	991,738	494,362	98,872
J.R	L....P	Samsung A04	450	3,215.36	321,536	4,853	485,318	163,782	32,756

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave ne Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 *Smartphones* të NKM, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **1,241,856** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. A.C me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. S.T me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

8. Deklarata R.15442 datë 19.05.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna te besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Samsung A04E për sasinë 80 copë është deklaruar 33\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 101.12 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë artikullin Samsung A04E është deklaruar 65.8\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 101.12 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.12

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Samsung A04E	80	3,337	266,957	6,654	532,296	265,339	53,068

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones**, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton 53,068 Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Z. A.D me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. N.H me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

9. Deklarata R.12766 datë 26.04.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna te besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 për sasinë 60 copë është deklaruar 75.5\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12 C për sasinë 60 copë është deklaruar 55.5\$, për artikullin Samsung A04E për sasinë 200 copë është deklaruar 50.1\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.96 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë artikullin Xiaomi Redmi Note 12 është deklaruar 126\$ për copë, artikullin Xiaomi Redmi Note 12C është deklaruar 72.8\$, për artikullin Samsung A04E është deklaruar 65.8\$ për copë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.13

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
M.L	M.....T	Samsung A04E	200	5,208	1,041,679	6,841	1,368,114	326,434	65,287
M.L	M.....T	Xiaomi Redmi Note 12 c	60	5,770	346,187	7,568	454,097	107,910	21,582
M.L	M.....T	Xiaomi redmi note 12	60	7,849	470,939	13,099	785,938	314,999	63,000

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones**, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **149,869** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. R.K me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. E.D me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

10. Deklarata R.5829 datë 20.03.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 c për sasinë 50 copë është deklaruar 66\$ për copë, për artikullin Samsung A04S për sasinë 60 copë është deklaruar 60.6\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 116.550 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për këtë për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 c është deklaruar 72.8\$ për copë, për artikullin Samsung A04S është deklaruar 65.8\$ për copë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.14

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasi a	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
G.A	L...G	samsung A04S	60	7,063	423,776	7,669	460,139	36,364	7,273
G.A	L...G	Xiaomi Redmi Note 12 c	50	7,692	384,615	8,485	424,242	39,627	7,925

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton 15,198 Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. R.K me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. E.D me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

11. Deklarata R.9971 datë 11.04.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Samsung A04E për sasinë 200 copë është deklaruar 55.5\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 108.430 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për artikullin Samsung A04E është deklaruar 65.8\$ për copë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.15

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
M.A	M.....T	Samsung A04E	200	6,018	1,203,573	7,135	1,426,939	223,366	44,673

Efekti financiar i përlogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në Kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones, të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton 44,673 Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër janë përgjegjës për këtë praktikë, doganierët Znj. A.C me detyrë doganiere në SVQ dhe Z. N.H me detyrë përgjegjës turni në SVQ.

12. Deklarata R.10865 datë 08.04.2023 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsye se mungon swift, proform kontrate. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda e 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna te besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 për sasinë 40 copë është deklaruar 85.5\$ për copë. Llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 103.960 lekë. Krahasuar me deklaratën me nr.R.41775 datë 18.12.2023 referuar për rivlerësim çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat është vlerësuar dhe pranuar për artikullin Xiaomi Redmi Note 12 është deklaruar 105.5\$ për copë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.16

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
M.A	M.....T	Xiaomi Redmi Note 12	60	8,889	355,543	10,968	438,711	83,168	16,634

38. Deklarata R.4647 datë 07.02.2024 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsyen se mungon swift, proform kontratë. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Samsung A04E për sasinë 100 copë është deklaruar 28\$ për copë, Xiaomi Redmi 13 C për sasinë 100 copë deklaruar me 35\$ për copë, Xiaomi Redmi 12 për sasinë 100 copë deklaruar me 30\$ për copë, llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 95.95 lekë. Krahasuar me deklaratën R.41775 datë 18.12.2023 çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat për artikullin Samsung A04E është vlerësuar dhe pranuar me 65.8\$ për copë, Xiaomi Redmi 13 C është vlerësuar dhe pranuar me 80.5\$ për copë dhe për artikullin Xiaomi Redmi 12 është vlerësuar dhe pranuar me 105.5\$ për copë, llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 95.95 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.42

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
A.D	M....T	Samsung A04E	100	2687	268,660	6,314	631,351	362,691	72,538
A.D	M....T	Xiaomi Redmi 13 C	100	2879	287,850	7,724	772,398	484,548	96,910
A.D	M....T	Xiaomi Redmi 12	100	2879	287,850	10,123	1,012,273	724,423	144,885

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones** të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **169,448** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

39. Deklarata R.2192 datë 20.01.2024 nuk plotëson kushtet për zbatimin e metodës 1 për arsyen se mungon swift, proform kontratë. Në bazë të udhëzimit 3 dhe 5 të Min.Fin dhe DPD për vlerën doganore u zbatua metoda 3 e vlerësimit sepse gjatë kontrollit në metodat e mëparshme nuk u gjetën të dhëna të besueshme për tu përdorur. Nga verifikimi i deklaratës së sipërcituar konstatohet se vlera për artikullin Samsung A04E për sasinë 100 copë është deklaruar 28\$ për copë, Xiaomi Redmi 13 C për sasinë 200 copë deklaruar me 35\$ për copë, llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 93.94 lekë. Krahasuar me deklaratën R.41775 datë 18.12.2023 çmimi është dukshëm më i ulët se vlera e pranuar për të njëjtin artikull identik. Pasi vlerat për artikullin Samsung A04E është vlerësuar dhe pranuar me 65.8\$ për copë, Xiaomi Redmi 13 C është vlerësuar dhe pranuar me 80.5\$ për copë, llogaritur me kursin e kohës 1\$ X 93.94 lekë. Nga krahasimi i deklaratës së vlerësuar me deklaratën pranuar rezulton se kemi diferencë në këtë produktet i cili do të pasqyrohet sipas tabelës.

Tabela nr.43

Subjekti	NUIS	Produkti	Sasia	Çmimi deklaruar për copë	Vlera e deklaratës	Rivlerësim	Vlera e rivlerësuar deklaratës	Diferenca në rivlerësim	Detyrimi munguar 20%
J.R	L....P	Samsung A04E	100	2630	263,032	6,181	618,125	355,093	71,019
J.R	L....P	Xiaomi Redmi 13 C	200	3288	657,580	7,562	1,512,434	854,854	170,971

Efekti financiar i përlllogaritur në praktikat doganore për deklarime të mallrave në **Kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones** të NKM, me origjinë EU/NEU. Rezulton **241,989** Lekë e cila do të konsiderohet si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Në përputhje me Kodin Doganor, metodën nr.3 të vlerësimit, bazuar në Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor në deklarim. Për artikullin “celular” në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, si edhe bazuar në origjinën e artikujve, u kontrolluan në faqet e përcaktuara nga DPD -si Aliexpress, www.trovaprezzi.it etj, ku u gjetën vlerat më të ulta nga të cilat u zbrit 30% nga çmimi sipas udhëzimit. Bashkangjitur formularit edhe tabela në Excel për mënyrën përlllogaritjes

Konkluzioni:

Nga auditimi konstatohet një vlerësim i gabuar për artikullin “celular” në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, si edhe bazuar në origjinën e artikujve, konstatohet se gjatë vlerësimit doganor janë kryer veprime në kundërshtim me nenet 65-70 të Kodit Doganor; VKM Nr.651, datë 10.11.2017, Për dispozitat zbatuese të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë”; Udhëzimi Nr.3, datë 23.01.2018, Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” dhe udhëzimit nr.5 datë 26.01.2018 mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit aposterior operativ pika IV të MF, procedurat që ndiqen nga SKAO, konkretisht me:

Nenin 162 Vlera doganore e mallrave identike ose të ngjashëm të VKM Nr.651, datë 10.11.2017;

Me Udhëzimin Nr.3 , datë 23.01.2018,

-Pikën 1. Parime të përgjithshme;

-Pikën 4.2. Metoda 2. Vlera e transaksionit e mallrave identike

-Pikën 4.3. Metoda 3. Vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme

Pikën 7. Profolizimi I riskut në vlerësimin doganor

Pikën 8. Dokumentacioni shtesë

Pikën 10. shkronja c Përdorimi I metodave të tjera.

4. Konstatohet moszbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me vlerësimin dhe importimin e artikujve që përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja.

Nga auditimi i pajisjeve mjekësore konstatohet se nuk janë zbatuar procedurat për kryerjen e kontrollove dokumentare dhe fizike lidhur me importin e implanteve mjekësore.

Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga: a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore. 2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit..

Nga auditimi i importit të implanteve mjekësore, për të cilat kërkohet pajisja me certifikatë regjistrimi nga AKBPM, strukturat kontrolluese doganore nuk kanë realizuar kontrole dokumentare dhe fizike për këto produkte më qëllim evidentimin e parregullsive. Disa nga këto produkte në import janë përjashtuar padrejtësisht nga pagimi i TVSH-së në import. Nga auditimi konstatohet se nga struktura kontrolluese nuk është bërë identifikimi i këtyre mallrave, identifikim i cili është i nevojshëm për të siguruar përputhjen mes deklarimeve dhe të dhënave përkatëse të lëshuar në certifikatën e regjistrimit të AKBPM. Këto veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173 të këtij kodi. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se akti i inspektimit mungon ose plotësohet me shënime të përgjithshme si “OK ose Rezulton në rregull” duke mos sqaruar veprimet dhe verifikimet e kryera gjatë kontrollit si dhe nuk zbatohet udhëzimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut” ku parashikohet shprehimisht detyrimet e degëve doganore në rast të përzgjedhjes së praktikave doganore në “Kanal të kuq” pika 2.1: b) *Në të gjitha rastet e ri kanalizimit, dega doganore pasqyron në mënyrë të detajuar në aktin e kontrollit arsyen e ri kanalizimit, veprimet e ndërmarra dhe rezultatet e kontrollit. Gjithashtu bazuar në pikën V/a të manualit, parashikohet që doganierët e kontrollit fizik duhet të mbajnë edhe një proces-verbal të kontrollit ku të regjistrohen shënime apo detaje të tilla si: Data, ora dhe vendi, kategoria dhe arsyet e kontrollit, personat e pranishëm gjatë kryerjes së kontrollit, të dhënat e pasaportës së deklaruesit/transportuesit, çfarë është gjetur, nëse është gjetur diçka, çfarë është thënë dhe nga kush.*

- Nga verifikimi i kodit tarifor 3006 gjatë vitit 2023 konstatohen se janë gjithsej 220 deklarata, me vlerë doganore 204,465,193 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditim 30 deklarata doganore, duke u renditur nga vlera më e lartë, të cilët përfaqësojnë vlerën doganore 107,637,888 lekë ose 53 % e vlerës totale. Nga auditimi rezultoi se për 6 raste kemi përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import, raste të cilat do trajtohen si më poshtë:

- Nga auditimi i praktikës R.35256 datë 30.10.2023 me subjekt D.C me NUIS L....F për rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “cemento dentare dhe mbushje të tjera, cimente e rindërtimit” konstatohet se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 3,837,800 lekë, me vlerë TVSH-je 767,560 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se artikulli nuk është i përfshirë në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.8417 datë 11.11.2020 lëshuar nga AKBPM. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti i inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.T me kodin J128 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur certifikatën me nr.8417 datë 11.11.2020, e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë

të nenit 251 pika 2 dhe duhet të paralizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **767,560** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit. *Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.*

Tabela nr.45

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
D.C	L....F	35256	30.10.2023	767,560	2,302,680	3,070,240

Efekti financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 3,070,240 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është *Z. F.L me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.*

-Nga auditimi i praktikës R.21783 datë 12.07.2023 me subjekt E.D me NUIS J....H për rezulton se mallrat e importuara konkretisht produkti me kodin “mjekësor 1362, 1363 dhe 2171” konstatojmë se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 689,944 lekë, me vlerë TVSH-je 137,989 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se produktet mjekësore nuk janë të përfshira në çertifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.5649/2 datë 19.09.2019 lëshuar nga AKBPM. Nga verifikimi në sistem konstatojmë se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatojmë se agjencia doganore A.2 me kodin J136 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.5649/2 datë 19.09.2019 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **137,989** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit, *“Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”*

Tabela nr.47

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
E.D	J....H	21783	12.07.2023	137,989	413,967	551,956

Efekti financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 551,956 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është *Znj. J.K me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.*

-Nga auditimi i praktikës R.31543 datë 30.09.2023 me subjekt E.D-ShPK me NUIS J.....H rezulton se për mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “ strukturë 2sc me kodin 1480 dhe kodin 1481” subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 2,980,068 lekë, me vlerë TVSH-je 596,014 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se artikulli nuk është i përfshirë në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.8232/2 datë 14.12.2022 lëshuar nga AKBPM. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore A.2 me kodin J136 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur certifikata me nr.8232/2 datë 14.12.2022 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të ishte penalizuar sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000 lekë**.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **596,014 lekë**. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravajtje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.49

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
E.D-ShPK	J.....H	31543	30.09.2023	596,014	1,788,042	2,384,056

Efekti financiar i përlllogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 2,384,056 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Z. E.Z me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.

-Nga auditimi i praktikës R.11185 datë 12.04.2023 me subjekt D.T me NUIS J....P rezulton se për mallrat e importuara nuk plotësojnë kriteret për përjashtim pasi certifikatat e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore lëshuar nga AKBPM me nr.5543/8 datë 21.11.2019 dhe certifikata me nr.6215/5 datë 20.11.2019 janë lëshuar për vendin e origjinës Zvicër dhe Portugali, ndërsa vendi i origjinës së produktit është importuar është Korea Jugut për të cilin nuk ka certifikatë të lëshuar nga AKBPM. Mallrat e përjashtuara për vlerën doganore janë në shumën 2,713,356 lekë, me vlerë TVSH-je 542,671 lekë.

Nga verifikimi dokumentacioni praktikës bashkëngjitur konstatohet se certifikata nr.5543/8 datë 21.11.2019 dhe certifikata me nr.6215/5 datë 20.11.2019 të lëshuara nga AKBPM kanë të përcaktuar si vend të origjinës Zvicër dhe Portugali, ndërsa produkti i ardhur ka si vendin e origjinës Korea e Jugut. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore D me kodin J033 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur certifikatën me nr.5543/8 datë 21.11.2019 dhe certifikatën me nr.6215/5 datë 20.11.2019 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000 lekë**.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **542,671 lekë**. nenit 253 “Kundrvatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.51

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
D.T	J...P	11185	12.04.2023	542,671	1,628,013	2,170,684

Efekt i financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 2,170,684 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Z. F.L me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.

- Nga auditimi i praktikës R.35339 datë 30.10.2023 me subjekt R.P me NUIS L....J, rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “CEMENTO DENTARE DHE MBUSHJE TË TJERA, CEMENTE E RINDËRTIMIT” është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 2,369,513 lekë, me vlerë TVSH-je 473,903 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se certifikata nr.730/2 datë 26.05.2017 e lëshuar nga AKBPM ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në urdhrin nr.734 datë 18.10.2018 protokolluar me nr.6045 prot datë 19.10.2018 i cili ka riformuluar pikën 8 të urdhrin nr.360 datë 22.08.2016 ku ka përcaktuar afatin 5-vjeçar të vlefshmërisë së certifikatës të lëshuara. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.T me kodin J128 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur certifikata me nr.730/2 datë 26.05.2017 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundërvajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000 lekë**. Pasqyruar sipas tabelës.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **473,903 lekë**. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundrvatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.53

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
R.P	L....J	35339	30.10.2023	473,903	1,421,709	1,895,612

Efekt i financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 1,895,612 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Znj. A.H me detyrë doganiere në DPD.

- Nga auditimi i praktikës R.12026 datë 19.04.2023 me subjekt R.P me NUIS L....J, rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “CEMENTO DENTARE DHE MBUSHJE TË TJERA, CEMENTE E RINDËRTIMIT” është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 2,020,743 lekë, me vlerë TVSH-je 404,149 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se çertifikata nr.730/2 datë 26.05.2017 e lëshuar nga AKBPM ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në urdhrin nr.734 datë 18.10.2018 protokolluar me nr.6045 prot datë 19.10.2018 i cili ka riformuluar pikën 8 të urdhërit nr.360 datë 22.08.2016 ku ka përcaktuar afatin 5-vjecar të vlefshmërisë së certifikatës të lëshuara. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.T me kodin J128 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.730/2 datë 26.05.2017 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **404,149** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravajtje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.55

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
R.P	L....J	12026	19.04.2023	404,149	1,212,447	1,616,596

Efekt i financiar i përlllogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 1,616,596 lekë për subjektin Shtetit dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Z. F.L me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.

- Nga verifikimi i kodit tarifor 3006 gjatë vitit 2024 konstatohen se janë gjithsej 205 deklarata, me vlerë doganore 205,767,835 lekë. Nga ana e grupit të auditimit u përzgjedhën për auditim 30 deklarata doganore, duke u renditur nga vlera më e lartë, të cilët përfaqësojnë vlerën doganore 128,390,020 lekë ose 62 % e vlerës totale.

Nga auditimi i praktikave doganore të importit të artikullit të kapitullit 30 produkte Farmaceutike të NKM konstatohet se në 30 deklaratat ka mangësi në plotësimin e kutisë 31 të deklaratave doganore ku nuk janë plotësuar të gjitha kriteret e saj, si përshkrimi i plotë dhe i detajuar për të bërë evidentimin e plotë të këtyre artikujve.

Nga auditimi rezultoi se për 6 raste kemi përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import, raste të cilat do trajtohen si më poshtë:

- Nga auditimi i praktikës R.29445 datë 03.08.2024 me subjekt A.P me NUIS L....N për mallrat e importuara konkretisht artikulli “CEMENTO DENTARE DHE MBUSHJE TË TJERA, CEMENTE E RINDËRTIMIT” konstatohet se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 7,194,748 lekë, me vlerë TVSH-je 1,438,950 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se artikulli nuk është përfshirë në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.4347/8 datë 03.11.2020 lëshuar nga AKBPM. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për

vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatojmë se akti inspektimit nuk ka të përshkuar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatojmë se agjencia doganore L.G me kodin J123 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur si dokument certifikatën me nr.4347/8 datë 03.11.2020 e cila në listën e saj nuk ka të përfshirë artikullin e përjashtuar nga AKBPM, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **1,438,950** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundratatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.57

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
A.P	L....N	29445	03.08.2024	1,438,950	4,316,850	5,755,800

Efekt i financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 5,755,800 Lekë për subjektin dhe 50, 000 lekë për agjencinë doganore të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Z. E.G me detyrë doganier në DPD.

- Nga auditimi i praktikës R.9778 datë 18.03.2024 me subjekt R.P me NUIS L....J, rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “CEMENTO DENTARE DHE MBUSHJE TË TJERA, CEMENTE E RINDËRTIMIT” konstatojmë se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 6,217,805 lekë, me vlerë TVSH-je 1,243,561 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se çertifikata nr.730/2 datë 26.05.2017 e lëshuar nga AKBPM ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në urdhrin nr.734 datë 18.10.2018 protokolluar me nr.6045 prot datë 19.10.2018 i cili ka riformuluar pikën 8 të urdhërit nr.360 datë 22.08.2016 ku ka përcaktuar afatin 5-vjeçar të vlefshmërisë së certifikatës të lëshuara, gjithashtu ky artikull nuk gjendet në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.15769 datë 13.02.2024. Nga verifikimi në sistem konstatojmë se akti inspektimit nuk ka të përshkuar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatojmë se agjencia doganore U.T me kodin J128 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.730/2 datë 26.05.2017 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë. Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **1,243,561** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundratatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.59

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
R.P	L....J	9778	18.03.2024	1,243,561	3,730,683	4,974,244

Efekti financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 4,974,244 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është *Z. F.L me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.*

- Nga auditimi i praktikës R.28875 datë 31.07.2024 me subjekt E.D-ShPK me NUIS J....H rezulton se për mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “CEMENTO DENTARE DHE MBUSHJE TË TJERA, CEMENTE E RINDËRTIMIT” është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 4,914,144 lekë, me vlerë TVSH-je 982,829 lekë. Nga verifikimi dokumentacioni praktikës bashkëngjitur konstatohet se çertifikata nr.2437/2 datë 26.04.2022 e lëshuar nga AKBPM ka përcaktuar si vend të origjinës Gjermani, ndërsa produkti i ardhur ka si vendin e origjinës Belgjikë. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.2 me kodin J098 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.2437/2 datë 26.04.2022 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **982,829 lekë**. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravajtje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.61

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
E.D	J....H	28875	31.07.2024	982,829	2,948,487	3,931,316

Efekti financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 3,931,316 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është *Znj J.K me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas dhe Z. A.B me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas.*

- Nga auditimi i praktikës R.24536 datë 01.07.2024 me subjekt R.P me NUIS L....J, rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “cemento dentare dhe mbushje të tjera, cemente e rindërtimit” është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 4,811,632 lekë, me vlerë TVSH-je 962,326 lekë. Nga dokumentacioni praktikës bashkëngjitur konstatohet se çertifikata nr.730/2 datë 26.05.2017 e lëshuar nga AKBPM ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në urdhrin nr.734 datë 18.10.2018 protokolluar me nr.6045 prot datë 19.10.2018 i cili ka riformuluar pikën 8 të urdhërit nr.360 datë 22.08.2016 ku ka përcaktuar afatin 5-vjecar të vlefshmërisë së certifikatës të lëshuara, gjithashtu ky artikull nuk gjendet në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.15769 datë 13.02.2024. Për rrjedhojë ky produkt nuk duhet të ishte përjashtuar nga pagimi TVSH-së për vlerën e sipërcituar. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit (kontrollit) nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.T me kodin J128 në

dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.730/2 datë 26.05.2017 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **962,326** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.63

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
R.P	L....J	24536	01.07.2024	962,326	2,886,978	3,849,304

Efekti financiar i përlllogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 3,849,304 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Z. J.S me detyrë doganier në DPD.

- Nga auditimi i praktikës R.44261 datë 18.11.2024 me subjekt R.P me NUIS L....J, rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “cemento dentare dhe mbushje të tjera, cemente e rindërtimit” konstatohet se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 3,352,059 lekë, me vlerë TVSH-je 670,412 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se çertifikata nr.730/2 datë 26.05.2017 e lëshuar nga AKBPM ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në urdhrin nr.734 datë 18.10.2018 protokolluar me nr.6045 prot datë 19.10.2018 i cili ka riformuluar pikën 8 të urdhërit nr.360 datë 22.08.2016 ku ka përcaktuar afatin 5-vjecar të vlefshmërisë së certifikatës të lëshuara, gjithashtu ky artikull nuk gjendet në certifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.15769 datë 13.02.2024. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkuar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore U.T me kodin J128 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr.730/2 datë 26.05.2017 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundravajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **670,412** lekë. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundravatje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.65

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
R.P	L....J	44261	18.11.2024	670,412	2,011,236	2,681,648

Efekti financiar i përlllogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 2,681,648 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër bazuar në udhëzimin nr.5 datë 26.01.2018 III përzgjedhja me kanal të verdhë, përgjegjës është Znj. A.C me detyrë doganiere në DPD.

- Nga auditimi i praktikës R.34151 datë 10.09.2024 me subjekt A.D group me NUIS L....L rezulton se mallrat e importuara konkretisht artikulli i parë “OLIETCH BOND S me kodin OL0021” konstatohet se subjekti është përjashtuar për vlerën doganore në shumën 1,727,821 lekë, me vlerë TVSH-je 345,564 lekë. Nga verifikimi dokumentacionit të praktikës bashkëngjitur konstatohet se artikulli nuk është i përfshirë në çertifikatën e regjistrimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore me nr.7238/2 datë 02.12.2019 lëshuar nga AKBPM. Nga verifikimi në sistem konstatohet se akti inspektimit nuk ka të përshkruar të gjithë elementët e duhur. Gjithashtu konstatohet se agjencia doganore L.G me kodin J123 në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës ka paraqitur çertifikata me nr. 7238/2 datë 02.12.2019 e cila nuk është e vlefshme për këtë rast, për rrjedhojë ky subjekt ka kryer kundrvajtje në bazë të nenit 251 pika 2 dhe duhet të penalizohet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 256 pika 1 gërma B të këtij kodi, në shumën **50,000** lekë. Pasqyruar sipas tabelës.

Për këtë rast konstatohet përjashtim të padrejtë të TVSH-së për shumën **345,564 lekë**. Kjo shkelje klasifikohet sipas ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor” nenit 253 “Kundrvajtje e kryer me Dashje” dhe sanksionohet sipas nenit 258 pika 1 e këtij ligjit: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.”

Tabela nr.67

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali për tu paguar
A.D group	L....L	34151	10.09.2024	345,564	1,036,692	1,382,256

Efekt i financiar i përlogaritur në këtë praktikë doganore, rezulton 1,382,256 lekë për subjektin dhe 50,000 lekë për agjencinë doganore, të cilat do të konsiderohet si të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Tabela përmbledhëse me detyrimet e munguara dhe penalitetet që duhet të ishin vendosur për subjekt e cituara me sipër.

Subjekti	NUIS	Nr Dek	Datë	Detyrimi munguar	Penalitet 3 Fish	Totali
A.P	L....N	29445	03.08.2024	1,438,950	4,316,850	5,755,800
R.P	L....J	9778	18.03.2024	1,243,561	3,730,683	4,974,244
E.D	J....M	28875	31.07.2024	982,829	2,948,487	3,931,316
R.P	L....J	24536	01.07.2024	962,326	2,886,978	3,849,304
R.P	L....J	44261	18.11.2024	670,412	2,011,236	2,681,648
D.C	L....F	35256	30.10.2023	767,560	2,302,680	3,070,240
E.D	J....H	21783	12.07.2023	137,989	413,967	551,956
E.D-shpk	J....H	31543	30.09.2023	596,014	1,788,042	2,384,056
D.T	J....P	11185	12.04.2023	542,671	1,628,013	2,170,684
R.P	L....J	35339	30.10.2023	473,903	1,421,709	1,895,612
R.P	L....J	12026	19.04.2023	404,149	1,212,447	1,616,596
A.D group	L....L	34151	10.09.2024	345,564	1,036,692	1,382,256
TOTALI						34,263,712

Tabela përmbledhëse me penalitetet që duhet të ishin vendosur për Agjencitë e cituara me sipër.

Agjencia	Kodi	Nr Dek	Datë	Penaliteti
L.G	J123	29445	03.08.2024	50,000
U.T	J128	9778	18.03.2024	50,000
U.2	J098	28875	31.07.2024	50,000
U.T	J128	24536	01.07.2024	50,000

U.T	J128	44261	18.11.2024	50,000
L.G	J123	34151	10.09.2024	50,000
U.T	J128	35256	30.10.2023	50,000
A.2	J136	21783	12.07.2023	50,000
A.2	J136	31543	30.09.2023	50,000
D	J033	11185	12.04.2023	50,000
U.T	J128	35339	30.10.2023	50,000
U.T	J128	12026	19.04.2023	50,000
Totali				600,000

III. 5. Auditimi i procedurave të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim.

Auditimi u fokusua në procedurat doganore të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga Dega Doganore Rinas të cilat kanë vlerë të lartë dhe autoritet kontrolluese/konstatuese kanë qenë struktura të kësaj dege doganore. Nga informacioni i paraqitur në periudhën në auditim janë nxjerrë në total 140 vendime, përkatësisht 50 vendime në 6 mujorin e dytë të vitit 2022, në vitin 2023 janë 48 vendime dhe në 2024 janë nxjerrë 42 vendime. Nga grupi i auditimit për këtë periudhë janë audituar 45 vendime të kësaj dege doganore.

Baza ligjore:

-Ligji nr.102 datë 31.07.2014"Kodi Doganor i RSh", i ndryshuar;

-Ligji nr.61, datë 24.05.2012 "Për Akcizat në RSh", i ndryshuar;

-VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të RSh", i ndryshuar;

-VKM nr.612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për Akcizat në RSH", i ndryshuar;

-Ligji nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", i ndryshuar;

-Urdhëri nr.146, datë 07.05.2018 i MFE Për miratimin e Rregullores së brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" dhe të Rregullores së brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore";

-Urdhëri nr.05, datë 12.01.2024 i DPD Për miratimin e Manualit udhëzues "Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës në Republikën e Shqipërisë".

Nga dokumentacioni i shqyrtuar konstatohet sa më poshtë:

I. Konstatojmë mangësi në ndjekjen e procedurave të verifikimit të shkeljeve doganore dhe mos dokumentimin e plotë të praktikës së shkeljes doganore. Konstatohet mos plotësim korrekt të procesverbaleve të verifikimit/konstatimit të shkeljeve doganore, dokumentimit të njoftimit të tyre, në procesverbalet për verifikimin/konstatimin e kundërvajtjeve administrative nuk janë vendosur nenet për përcaktimin e kundërvajtjeve administrative të kryera, nenet për sanksionet e vendosur apo nuk është dokumentuar njoftimi i shkelësit, veprime në kundërshtim me nenet 273-274-276 të Kodit Doganor.

II. Konstatojmë klasifikim të gabuar të kundërvajtjeve administrative në procesverbalet për verifikimin e shkeljeve doganore si dhe vendimet përkatëse. Konstatohen në raste kur nga kontrolli fizik kanë rezultuar mallra më tepër se deklarimi veprime në kundërshtim me nenet 251 deri 255 Kundërvajtjet administrative dhe nenet 256 deri 261 sanksionet për kundërvajtjet të Kodit Doganor.

I. Nga auditimi konstatohen mangësi në ndjekjen e procedurave të verifikimit të shkeljeve doganore, mos dokumentimin e plotë të dosjes së shkeljes, mungesës së përcaktimit të bazës ligjore ku qëndron shkelja, kundërvajtja administrative dhe sanksionet e vendosura apo mos dokumentimin e njoftimit të shkelësit konstatohen në proces verbalet e verifikimit/ konstatimit.

Konkretisht, u konstatua mungesë e bazës ligjore të shkeljes:

- proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative Nr.2709, datë 24.08.2022, nr.serial 0010642, vendimi nr.44, datë 24.08.2022, verifikues; K.D, A.B; -Nr.2945, datë

16.09.2022, nr.serial 0010644, vendimi nr.49, datë 05.10.2022, nuk është përcaktuar neni i shkelur për kundërvajtjen, verifikues K.D, A.B;

-Nr.3338, datë 18.10.2022, vendimi nr.56, datë 21.10.2022, verifikues M.I, A.B; A.K Nr.3292, datë 13.10.2022,

-nr.serial 0010648, vendimi nr.58, datë 02.11.2022, verifikues M.I, A.B; A.K; Mangësi të mungesës së bazës ligjore dhe njoftimi/nënshkrimi i shkelësit: Nr.3113, datë 30.09.2022,

-nr.serial 0010645, vendimi nr.46, datë 03.10.2022, verifikues M.I, A.B; mungon deklarimi i shkelësit dhe nënshkrimi; Nr.3263, datë 12.10.2022,

-nr.serial 0010647, vendimi nr.51, datë 13.10.2022, verifikues K.D, A.B; A.K mungon deklarimi i shkelësit dhe nënshkrimi. Strukturë konstatuese kontrolli fizik sektori Cargo.

Proces verbale konstatimi me mungesë të bazës ligjore, neneve të shkeljes doganore dhe njoftimit:

-Viti 2022:

Proces verbal konstatimi (regjime), nr.3200, datë 06.10.2022, vendimi nr.50, datë 06.10.22 nuk ka bazën ligjore e nuk ka nënshkrimin e shkelësit. Konstatues F.L, A.B.

-Për vitin 2023:

Proces verbal konstatimi nr.1283, datë 27.04.2023, vendimi nr.22, datë 26.05.2023, mungon baza ligjore e kundërvajtjes dhe sanksionit, mungon njoftimi dhe nënshkrimi i subjektit.

Proces verbal konstatimi nr.362, datë 06.02.2023, vendimi nr.8, datë 06.02.2023, mungon baza ligjore e kundërvajtjes dhe sanksionit, mungon nënshkrimi e njoftimi i subjektit, konstatues F.L, A.B;

Proces verbal konstatimi nr.110, datë 11.01.2023, vendimi nr.3, datë 24.01.2023, mungon baza ligjore e kundërvajtjes dhe sanksionit, mungon nënshkrimi e njoftimi i shkelësit, konstatues F.L, A.B. Strukturë konstatuese kontrolli fizik regjime sektori Cargo.

Mangësi në kryerjen e procedurave të verifikimit të kundërvajtjes:

-Në proces verbalin e konstatimit nga aposteriori dhe përgjegjësi i Cargos nr.2940, datë 15.09.2022, vendimi nr.54, datë 14.10.2022 A.B e A.K ka nënshkrimin e agjensisë.

-Proces Verbal Konstatimi Nr.2734, datë 25.09.2023 (vendimi nr.34, datë 25.10.2023); Nr.2655, datë 15.09.2023, (vendimi nr.31, datë 20.10.2023); Nr.2674, datë 19.09.2023, (vendimi nr.29, datë 28.09.2023); nga Përgjegjësi Cargos A.B dhe Sektori i Kontrolleve Pas Zhdoganimit M.J nuk ka njoftimi e as nënshkrim; Nr.987/1, datë 06.04.2023, (vendimi nr.13, datë 06.04.2023) nga Përgjegjësi Cargos A.B dhe A.K nuk ka njoftim e nënshkrim. Mangësi në përmbajtje të aktit të pasqyrimin të të drejtës për ankim dhe afatin e tij. Strukturë konstatuese kontrolli Aposteriori.

-Proces verbal konstatimi datë 31.10.2024,(regjime kalim afati), nuk ka nenet e shkelura (vendimi 41, datë 05.12.2024). Konstatues F.L, A.B. Strukturë konstatuese kontrolli fizik regjime sektori Cargo.

- Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes doganore nr.1077 prot., datë 11.04.2024, nr. serial 0010570, nuk ka deklarimin e shkelësit/shkelësive dhe nënshkrimin. (vendimi nr.28, datë 12.07.2024). Konstatues A.B dhe K.D. Strukturë konstatuese kontrolli fizik sektori Cargo.

-Proces verbali konstatimit nr.3896 prot., datë 20.12.2023 nuk ka bazën ligjore të shkeljes dhe njoftimin e subjektit (Vendimi nr.4, datë 11.01.2024). Konstatues Kontrolli Aposterior M.J dhe përgjegjësi Cargos A.B. Në 3 vendimet e mësipërme baza ligjore është vendosur. Strukturë konstatuese kontrolli Aposteriori.

Mangësi në dokumentimin e plotë të praktikës së shkeljes doganore. Konstatohet se proces verbalet e verifikimit / konstatimit të shkeljeve nuk kanë bashkëlidhur dokumentacionin që lidhet me shkeljen e verifikuar që provojnë/argumentojnë kundërvajtjen. Gjithashtu

konstatohen mangësinë dokumentimin e përmbajtjen e dosjes që shqyrtohet për marrjen e vendimit, mangësi në përgatitjen e plotë të dosjes të vendimeve të audituara.

Veprime në kundërshtim me nenet 273, 274 dhe 276 të Kodit Doganor ku përcaktohen:

Neni 273 Procedura e verifikimit

1. Shkeljet doganore verifikohen dhe dënohen, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionin në fuqi.
2. Për qëllime të këtij kreu, “autoritete doganore kompetente” do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrole në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar.
3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, nga ana e strukturave doganore që kanë konstatuar shkeljen mbahet një procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë që kryejnë verifikimin e kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij.
4. Në rastet kur shkelja nuk është konstatuar në prani të shkelësit, procesverbali i nënshkruar nga punonjësit doganorë të strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga kjo strukturë brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së njoftimit, pranë strukturës përkatëse.
5. Strukturat kontrolluese, pas shqyrtimit të pretendimeve, u dërgojnë autoriteteve doganore kompetente procesverbalin përfundimtar së bashku me pretendimet e shkelësit.

Neni 274 Forma e procesverbalit të verifikimit e të sekuestrimit

1. Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë:

- a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;
- b) emrat e personave që nënshkruajnë dhe autoritetin/strukturën që përfaqësojnë;
- c) të dhëna identifikuese të shkelësit/shkelësve;
- ç) llojin e shkeljes së kryer;
- d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja;
- dh) identifikimin e mjetit/mjeteve të transportit;
- e) treguesit që lidhen me sasinë, llojin, vlerën dhe origjinën e mallrave që janë objekt i shkeljes;
- ë) shumën e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar;
- f) nenet e shkelura, nenet, në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;
- g) nënshkrimin e punonjësve të doganës të strukturave kontrolluese dhe, kur është i pranishëm, nënshkrimin e shkelësit. Kur shkelësi nuk pranon të nënshkruajë, në procesverbal shënohet se atij i është lexuar kërkesa për të nënshkruar dhe se i është dorëzuar një kopje.

Neni 276 Marrja e vendimit dhe njoftimi.

1. Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës.

Për sa më sipër, për mangësitë e konstatuara janë Përgjegjës strukturat konstatuese, doganierët kontrollues, verifikues të shkeljeve doganore dhe juristi i degës doganore: A.B, K.D, M.I, M.J, F.L, A.K, A.S.

II. Konstatohet klasifikim i gabuar i kundërvajtjeve administrative në proces verbalet për verifikimin e shkeljeve doganore si dhe vendimet përkatëse të mëposhtme:

Për vitin 2022

1. Nga auditimi i Vendimit nr.40, datë 18.08.2022 për subjektin “O.A” PF NUIS L....M , lidhur me deklaratën doganore R24149, datë 01.08.2022, ku në proces verbalin nr.2480 prot., datë 02.08.2022 është konstatuar se nga kontrolli fizik ka rezultuar mall më tepër se deklarimi, nga

auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a, por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penalitet i munguar në shumën **18,889 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Proces verbali nr.serial 0010640, datë 02.08.2022 verifikuesit doganier K.D dhe shef sektori A.B. Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore (formati tip sipas udhëzimit), nuk ka deklarimin e shkelësit e nënshkrimin.

2. Nga auditimi i Vendimit nr.44, datë 24.08.2022 për subjektin subjekti “J.R” PF NUIS L...P deklarata doganore R26836, datë 23.08.2022, ku në proces verbalin nr.2709 prot., datë 24.08.2022 është konstatuar se nga kontrolli fizik i deklaratës rezulton mall më tepër se deklarimi, nga auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penalitet i munguar në shumën **31,820 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Proces verbali nr.serial 0010642, datë 24.08.2022, verifikuesit doganier K.D dhe shef sektori A.B. Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore (formati tip sipas udhëzimit) ka deklarimin e shkelësit “dakord” dhe nënshkrimin.

3. Nga auditimi i Vendimit nr.69, datë 15.11.2022 për subjektin “R.E” SHPK NUIS M...M deklarata doganore R36906, datë 14.11.2022, është konstatuar se nga kontrolli fizik i deklaratës rezulton mall më tepër se deklarimi, nga auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penalitet i munguar në shumën **11,305 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Proces verbali nr.serial 0010772, datë 14.11.2022 verifikuesit doganier K.D dhe shef sektori A.B. Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore tip sipas udhëzimit ka nënshkrimin e shkelësit.

Për vitin 2023

1. Nga auditimi i Vendimit nr.30, datë 20.10.2023, për subjektin “E.M” PF NUIS K...C, deklarata doganore R33421, datë 16.10.2023 proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative nr.3019 prot., datë 19.10.2023, është konstatuar se nga kontrolli fizik ka rezultuar mall më tepër se deklarimi, nga auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a, por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penalitet i munguar në shumën **107,916 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Proces verbali nr.serial 0010796, datë 19.10.2023 verifikuesit doganier K.D dhe shef sektori A.B. Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore tip sipas udhëzimit ka deklarimin dakord dhe nënshkrimin e shkelësit.

Për vitin 2024

1. Nga auditimi i Vendimit nr.22, datë 24.05.2024, për subjektin subjekti “A.O” PF me NUIS M...N Agjensia D.L J015, deklarata doganore R18607, data 21.05. 2024 proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative nr.1568, datë 24.05.2024 nr. serial 0010576 , është konstatuar se nga kontrolli fizik ka rezultuar mall më tepër se deklarimi, nga auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a, por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d

dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penaliteti i munguar në shumën **39,954 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. (deklarimi i shkelësit dhe nënshkrimi është). Konstatues pjesëmarrës K.D, A.B.

2. Nga auditimi i Vendimit nr.32, datë 18.09.2024, për subjektin “R.E” SHPK me NUIS M...H Agjensia A.A, Deklarata doganore R31366, datë 19.08.2024 proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative nr.2535, datë 26.08.2024, nr serial 0010579, është konstatuar se nga kontrolli fizik ka rezultuar mall më tepër se deklarimi, nga auditimi konstatohet se kjo vendimmarrje e autoritetit doganor është klasifikuar në nenet 250/1/a; 251/1/a dhe 256/1/a, por klasifikimi për këtë lloj shkelje duhet të ishte bazuar në nenin 252/d dhe sanksioni sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, duke aplikuar masën dyfish të detyrimit. Si rezultat i mangësive të konstatuara rezulton penaliteti i munguar në shumën **62,325 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. (deklarimi i shkelësit dhe nënshkrimi është). Konstatues pjesëmarrës M.I, A.B.

Veprime në kundërshtim me Kodin Doganor nenet 252 dhe 257, ku përcaktohet klasifikimi i këtyre kundërvajtjeve dhe sanksioneve përkatëse: *Neni 252 Kundërvajtje të kryera në neglizhencë pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë: d) mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të paraqitur mallrat, të cilat janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pranë autoriteteve doganore, në përputhje me nenin 130; Neni 257 Sanksionet për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë*

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferencë në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;

Në kundërshtim me Urdhërin nr.146, datë 07.05.2018 i MFE Për miratimin e Regullores së brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” dhe të Regullores së brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore”.

Për sa më sipër, në bazë të legjislacionit doganor, bazës ligjore të mësipërme, përgjegjës për mangësitë e konstatuara janë: A.B, K.D, M.I, A.S.

Tabela e vendimeve me klasifikim të gabuar të shkeljeve dhe sanksioneve të vendosura:

Në lekë

Vendimi nr/datë	Emri i subjektit/NUIS	Deklarata doganore IM4 , nr/datë	Sanksioni i munguar
Vendimi nr.40, datë 18.08.2022	“O.A” PF, NUIS L...M	R24149, datë 01.08.2022	18,889
Vendimi nr.44, datë 24.08.2022	“J.R” PF, NUIS L...P	R26836, datë 23.08.2022	31,820
Vendimi nr.69, datë 15.11.2022	“R.E”SHPK NUIS M...M	R36906, datë 14.11.2022	11,305
Vendimi nr.30, datë 20.10.2023	E.M PF, K...C	R33421, datë 16.10.2023	107,919
Vendimi nr.22, datë 24.05.2024	“A.O”PF me NUIS M...N	R18607, data 21.05. 2024	39,954
Vendimi nr.32, datë 18.09.2024	“R.O”SHPK me NUIS M...H	R31366, datë 19.08.2024	62,325

Sa më sipër, nga auditimi i procedurave doganore të ndjekura mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor për periudhën nën auditim konstatohen:

-Mangësi në kryerjen e procedurave të verifikimit dhe mosdokumentim i plote i praktikës së shkeljeve doganore

-Klasifikim i gabuar i shkeljeve doganore dhe sanksionit të vendosur

Për sa më sipër, në bazë të legjislacionit doganor, bazës ligjore të mësipërme, përgjegjës për mangësitë e konstatuara janë: A.B, K.D, M.I, M.J, F.L, A.K, A.S dhe Kryetari i Degës Doganore Rinas z. L.M.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizuar mbi performancën e të ardhurave doganore të Degës së Doganës Rinas, në krahasim me planin e parashikuar, u konstatua se për periudhën 2022–2024, të ardhurat doganore në total janë realizuar mbi pritshmëritë, duke rezultuar në një tejkalim të planit të përcaktuar, konkretisht: për vitin 2022 me një realizim në masën 103%, ku janë realizuar të ardhura në vlerën 2,777,356 mijë lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 2,693,396 mijë lekë; për vitin 2023 me një realizim në masën 103%, ku janë realizuar të ardhura në vlerën 3,209,097 mijë lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 3,101,230 mijë lekë; për vitin 2024 me një realizim në masën 117%, ku janë realizuar të ardhura në vlerën 3,745,463 mijë lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 3,201,279 mijë lekë. Me mos realizim rezultojnë të ardhurat nga taksa doganore, të cilat për vitin 2024 paraqiten me një mosrealizim në vlerën -4,271 mijë lekë ose në realizim në masën 98%. Me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga akciza për vitet 2022-2024, të cilat konkretisht rezultojnë me mosrealizim në vlerën -13,266 mijë lekë ose realizim në masën 80% për vitin 2022, mosrealizim në vlerën -14,356 mijë lekë ose realizim në masën 66% për vitin 2023 dhe mosrealizim në vlerën -4,303 mijë lekë ose realizim në masën 86% për vitin 2024 kundrejt planit, ku ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri është ndryshimi i kursit të këmbimit nëpërmjet mbi çmimit të lekut. Konstatohet se pavarësisht uljes së planit të të ardhurave nga akciza vit pas viti i pashoqëruar me analiza konkrete, keq planifikimi si pasojë e mospërfshirjes së Degës Doganore Rinas në vendimmarrje mbi këtë proces që përcillet për zbatim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka ndikuar drejtpërsëdrejti në mos realizimin e të ardhurave nga akciza.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 11-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: DD Rinas të analizojë shkaqet e mosrealizimit të planit të të ardhurave për periudhën objekt auditimit dhe njëkohësisht në vijimësi të marrë masat e nevojshme për realizimin e planit të të ardhurave për të gjithë zërat e parashikuara në planin mujor/vjetor të ardhur nga DPD.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se plani vjetor i ndarë në muaj për të ardhurat e planifikuara për t'u realizuar nga Dega e Doganës Rinas përgatitet nga DPD pa marrë në konsideratë dhe pa u analizuar me DDR, duke sjellë për pasojë mungesën e një plani fillestar, si dhe shoqëruar me ndryshime të shpeshta gjatë vitit. Si pasojë, realizimi i të ardhurave nuk pasqyron performancën reale të kësaj dege doganor. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se statistikatat e realizimit të të ardhurave paraqiten në nivel tepër sintetik dhe të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizim apo mosrealizim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 11-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrin masat për të përmirësuar procesin e planifikimit të të ardhurave doganore, në funksion të rritjes së performancës së veprimtarisë së degëve doganore në mbledhjen e të ardhurave,

rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së nëpunësve, duke i bërë pjesë të këtij procesi, si dhe duke shmangur praktikat e ndryshimeve të shpeshta në planifikim.

- Dega Doganore Rinas, të ndjekë limitet e përcaktuara në planin mujor duke kryer analiza të mirëfillta sipas llojit të të ardhurave doganore të gjeneruara, për të përcaktuar saktë faktorët që ndikojnë në nivelin e atë ardhurave doganore sipas llojit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Dega e Doganës Rinas, në fillim të periudhës së auditimit 01.07.2022 paraqitet me një borxh doganor në vlerën 10,814,999 lekë, që i përket 17 rasteve. Borxhi në fundin e vitit 2022 ka ardhur në rënie për pjesën e mbetur të vitit, e përfaqësuar nga 18 raste në shumën 8,675,083 lekë. Përgjatë vitit 2023 rezultoi një rritje e borxhit, si pasojë e vendimeve administrative të reja të degës e përfaqësuar në fund të vitit nga 15 raste në shumën 9,322,203 lekë. Në këtë vit u konstatua se jo vetëm që nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të mbartura, por këto detyrime janë shtuar si pasojë e vendimeve administrative të reja dhe shtesave nga kamatvonesat. Gjatë vitit 2024 borxhi doganor paraqitet i pandryshuar në të njëjtën shumë prej 9,322,203 lekë, që tregon për mos marrjen e masave të duhura për rikuperimin e tij dhe në të njëjtën kohë mos llogaritje të kamatvonesave.

-Nga auditimi i gjendjes dhe masave të marra për rikuperimin e borxhit nga Dega e Doganës Rinas për periudhën nën auditim, për subjektin debitor “A.D.F Distributor” me Nuis J...L, rezultoi se është konstatuar vonesë në nxjerrjen e VRFB, pasi 3 vendime të shpalljes debitor janë nxjerrë me datë 01.12.2021 dhe 1 vendim i shpalljes debitor është nxjerrë në datën 10.12.2021, ndërsa VRFB janë nxjerrë me datë 07.02.2022 jashtë afatit ligjor të parashikuar në Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës”. Zyra Juridike në Degën Doganore Rinas pas marrjes dijeni për zbatimin e masave garantuese/ rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, ka kërkuar në gjykatë lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me datë 30.03.2022. Në datën 30.11.2022 zyra Juridike/Borxhit në Degën Doganore Rinas i është drejtuar me shkresën nr.430/1 prot., datë 30.11.2023 për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit (Titullit Ekzekutiv), mbështetur në vendimin nr.460, datë 30.03.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë zyrës së Përmbartimit Shtetëror për marrjen e masave garantuese/ dhe ose rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara. Ndërsa nga vetë autoriteti doganor, përmes strukturës së zyrës Juridike/Borxhit nuk është marrë asnjë masë për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 14-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

3.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të marrë të gjitha masat dhe për të ezauruar të gjitha fazat e procedurës së vjeljes së detyrimeve deri në ekzekutimin me forcë të vendimit për rikuperimin e borxhit doganor.

-Dega Doganore Rinas përmes strukturës së zyrës Juridike/Borxhit të marrë masa për rikuperimin me forcë të borxhit doganor për subjektin A.D.F Distibutor me Nuis J....L, si dhe të kërkojë informacion zyrës së Përmbartimit Shtetëror për hapat e ndërmarra prej tyre, në procesin e rikuperimit me forcë të borxhit doganor dhe të akcizës, të marra ndaj këtij subjekti me qëllim mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi mbi rregullshmërinë e dokumentacionit të administruar në dosjet e borxhit kanë rezultuar mangësi, pasi asnjëra nga dosjet nuk është shoqëruar me inventarin fizik, veprim i cili është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9154 datë

06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Vendimin nr.4, datë 19.06.2017 të Këshillit të Lartë të Arkivave për miratimin e “Rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 4 dhe 8. Gjithashtu jo të gjitha dosjet janë plotësuar rregullisht me dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 15, datë 03.12.2018, Kapitulli XV “Dokumentacioni për detyrimet e papaguara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas të marrë masa që dosjet e borxhit doganor të jenë të shoqëruara me inventarin fizik dhe të plotësohen me dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me ligjin dhe udhëzimin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitor të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Degës Doganore Rinas për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Degës Doganore Rinas për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 90,139,640 lekë, ndërsa sektori borxhit në fund të vitit 2022 raporton se borxhi doganor është në vlerën 8,675,083 lekë. Pra, rezultojnë diferenca midis kontabilitetit dhe sektorit të borxhit në vlerën 81,464,557 lekë, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 3.2 trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (Klasa 4). Diferenca rezulton të jetë borxh Doganor i trashëguar nga vitet e kaluara duke nisur që nga viti 2010, 2011, 2012,2013 e në vazhdim në të cilin nuk është pasqyruar fshirja/shuarja e detyrime doganore, sipas ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas, Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Borxhit të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për rakordimin e llogarisë nr.468, për diferencën në vlerën 81,464,557 lekë, me evidencat e detyrimeve doganore të papaguara me qëllim sistemimin e tyre në vlerën e saktë të debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë se procedurave doganore lidhur me veprimtarinë e Regjimit të Magazinimit të Përkohshëm u konstatua mos kryerja e kontrolleve periodike tre mujore, ndërsa lidhur me mallrat që u ka kaluar afati 90 ditor u konstatua mos rregullim të situatës së tyre në përputhje të Kodit Doganor, veprime në kundërshtim me Nenin 139 Përfundimi i magazinimit të përkohshëm të Kodit Doganor; Neni 137 Kushtet dhe përgjegjësitë për magazinimin e përkohshëm të mallrave. Nga auditimi i përputhshmërisë se procedurave doganore lidhur me veprimtarinë e Regjimit të Lejimit të Përkohshëm për procedurat e ndjekura për mbikëqyrjen e këtyre regjimeve u konstatua moskryerje të kontrolleve të regjimeve lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre, veprime në kundërshtim me Kodin Doganor, Neni 194 “Regjistrimet”. Regjimit të Përpunimit Aktiv u konstatuan mangësi si moskryerje të kontrolleve dokumentare apo fizike të regjimit dhe mangësi në përmbajtjen e dosjes së regjimit, mungesë të raporteve për cdo kontroll të kryer apo akt rakordimet e mbajtura,veprime në kundërshtim me pikën XIII. Mbikëqyrja e regjimit, me pikën XV. Detyrimet e doganierit mbikqyrës të Udhëzimit nr.4, datë 28.09.2018 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 25-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas, doganierët mbikqyrës së Regjimit Magazinimit të Përkohshëm të kryejnë kontrolle çdo tre muaj të marrin të gjitha masat për rregullimin e situatës

së mallrave që u ka kaluar afati i qëndrimit 90 ditor, si dhe të kryejnë kontrolle të regjimeve lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre.

Dega Doganore Rinas, doganierët mbikqyrës së Regjimit të Përpunimit Aktiv të kryejnë kontrolle dokumentare apo fizike, të mbajnë raporte për çdo kontroll të kryer apo akt rakordimet e mbajtura.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura gjatë veprimtarisë së deklaratimit doganor në lidhje me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave për periudhën nën auditim u konstatua se për formularin mbi rivlerësimin doganor nuk është plotësuar pika 3, shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit shoqëruar dhe pika 4 vendimmarrja, në lidhje me argumentimin sa më të plotë për procesin dhe mënyrën e vlerësimit doganor, veprime këto në kundërshtim me udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018 “*Mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qendror dhe sektorit të kontrollit aposterio operativ*”. Gjithashtu nga auditimi i procedurave të verifikimit të shkeljeve doganore të ndjekura nga Dega Doganore Rinas, në strukturat verifikuese e konstatuese të shkeljeve doganore u konstatuan mangësi në përmbajtjen e procesverbaleve të shkeljeve doganore lidhur me mungesën e neneve të shkelura, të sanksioneve të vendosura, mosdokumentimi i njoftimeve për shkeljet doganore si dhe mungesa e dokumentimit të plotë të praktikave përkatëse, veprime në kundërshtim me nenet 273,274 dhe 276 të Kodit Doganor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.4.2, faqe 30-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Degës Doganore Rinas të merren masat për rishikimin e formularëve të konstatuar me mungesa dhe të merren masa për plotësimin në mënyrë që të sigurohet një vendimmarrje e saktë mbi analizë të hollësishme të dokumentacionit shoqëruar. -Dega Doganore Rinas në procedurat e verifikimit të shkeljeve doganore, në përmbajtje të procesverbaleve të verifikimit /konstatimit të shkeljeve doganore të vendosë nenet e shkelura, nenet e sanksioneve të vendosura, të dokumentojë njoftimet e tyre dhe të bëjë dokumentimin e plotë të praktikës së shkeljeve doganore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së borxhit doganor pranë Degës së Doganës Rinas, për periudhën objekt auditimi 01.07.2022-31.12.2024 rezultoi se nuk janë përlllogaritur kamatëvonesat siç përcaktohet në nenin 107, të ligjit nr.102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe në Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 në kreun V. Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi tyre për 2 rastet konkretisht Subjekti: M.H me NUIS J....G dhe subjekti E.K me NUIS J...F, në vlerën totale 29,524 lekë. Gjithashtu nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 “*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës*“, pasi subjekti debitor E.K ka likuiduar detyrimin doganor dhe penalitetin, por nga Dega Doganore Rinas nuk është përlllogaritur kamatëvonesa në vlerën 17,889 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 14-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas të rishikojë detyrimet e paguara, të cilat janë klasifikuar si borxh doganor dhe detyrimet e papaguara për periudhën objekt auditimi, ku të përlllogarisë kamatëvonesat rast pas rasti sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga ana e Degës së Doganës Rinas lidhur me vlerësimin doganor, u konstatua se ka mos përfshirje në vlerën për qëllime doganore të mallrave me skonto, duke mos zbatuar dispozitat ligjore të parashikuar në nenet 66-70 të Kodit Doganor si dhe udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”. Kjo është konstatuar në importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin “12. Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta te ndryshme; bimet industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia”, të NKM, me origjinë EU/NEU.

Gjatë vitit 2023 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë audituar 275 deklarata me vlerë të deklaruar 603,796,236 lekë dhe kanë rezultuar 8 deklarata me mangësi. Efekti financiar i përlloritur rezulton 1,639,480 lekë, i cili përbën të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

Gjatë vitit 2024 në Degën Doganore Rinas për artikujt e këtij kapitulli janë audituar 279 deklarata me vlerë të deklaruar 559,180,777 lekë dhe kanë rezultuar 5 deklarata të përpunuara me mangësi. Efekti financiar i përlloritur rezulton 827,186 lekë, e cila përbën të ardhura të munguar në Buxhetin e Shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilloritura **në shumën totale prej 2,466,666 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin 85 kodi tarifor 85171300 *Smartphones* të NKM, me origjinë EU/NEU u konstatua se gjatë vitit 2023 në 30 raste dhe në vitin 2024 në 9 raste në Degën Doganore Rinas, për artikujt e këtij kapitulli janë konstatuar vlerësime të gabuara pasi nuk janë kryer në përputhje me Kodin Doganor, metodën nr.3 të vlerësimit, bazuar në Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, si edhe bazuar në origjinën e artikujve.

Nga auditimi mbi aktivitetin e sektorit të vlerësimit në qendër (SVQ) dhe sektorit të kontrollit aposterior operativ (SKAO) u konstatua se metoda e aplikuar për vlerësimin e këtyre deklaratave nuk është e justifikuar, referuar dokumentacionit të praktikave doganore, pasi për të njëjtin artikull kemi qëndrime të ndryshme lidhur me vlerësimin doganor. Këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në nenet 66-70 dhe 251 të Kodit Doganor, udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të MFE “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” dhe udhëzimit nr.5, datë 26.01.2018 “Mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qëndror dhe sektorit aposterior operativ” pika IV, procedurat që ndiqen nga SKAO. Efekti financiar i të ardhurave të munguara si pasojë e vlerësimit të gabuar për kodin tarifor “85171300” për vitin 2023 paraqitet në shumën 5,478,299 lekë, konstatuar në 30 raste dhe për vitin 2024 paraqitet në shumën 3,564,919 lekë, konstatuar në 9 raste.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilloritura **në shumën totale prej 9,043,218 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat doganore në lidhje me vlerësimin dhe importimin e artikujve “pajisje mjekësore” u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat për kryerjen e kontrollove dokumentare dhe fizike lidhur me importin e implanteve mjekësore, si grup artikujsh që përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja. Nga auditimi i importit të implanteve mjekësore, për të cilat kërkohet pajisja me certifikatë regjistrimi nga AKBPM, strukturat kontrolluese doganore nuk kanë realizuar kontrolle dokumentare dhe fizike për këto produkte më qëllim evidentimin e parregullsive. Disa nga këto produkte në import janë përjashtuar padrejtësisht nga pagimi i TVSH-së në import. Nga auditimi u konstatua se nga struktura kontrolluese nuk është bërë identifikimi i këtyre mallrave, identifikim i cili është i nevojshëm për të siguruar përputhjen mes deklarimeve dhe të dhënave përkatëse të lëshuar në certifikatën e regjistrimit të AKBPM. Këto veprime bien ndesh me dispozitat ligjore të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173 të këtij kodi.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se akti i inspektimit mungon ose plotësohet me shënime të përgjithshme si “OK ose Rezulton në rregull” duke mos sqaruar veprimet dhe verifikimet e kryera gjatë kontrollit si dhe nuk zbatohet udhëzimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut” ku parashikohet shprehimisht detyrimet e degëve doganore në rast të përzgjedhjes së praktikave doganore në “Kanal të kuq” pika 2.1.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023, në 6 raste është konstatuar përjashtim i padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import me pasojë të ardhura të munguara për TVSH dhe sanksionet në vlerën 3-fish të detyrimit, në total në vlerën 11,689,144 lekë, si dhe për vitin 2024 në 6 raste në vlerën totale 22,574,568 lekë.

Për të 12 praktikat e evidentuara me mangësi, në referencë të nenit 251, pika 2 të Kodit Doganor agjencitë doganore janë objekt i penalizimit me gjobë në shumën 50,000 lekë/rast, në total për periudhën objekt auditimi në shumën 600,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 57-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa të menjëhershme me qëllim fillimin e procedurave ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin ligjor të konstatimeve duke përfshirë shqyrtimin, vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore të munguara të rilogaritura në shumën totale prej 34,863,712 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura lidhur me vendimet doganore nga Dega Doganore Rinas u konstatua mostrajtimi i drejtë i shkeljeve doganore, klasifikim i gabuar në 6 raste i shkeljeve doganore dhe sanksioneve të vendosura në nenet 251 dhe 256 të Kodit Doganor, si rezultat i mos aplikimit së penalitetit në shumën 272,212 lekë, veprime në kundërshtim me nenet 251, 256, 252, 257 të Kodit Doganor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 66-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas të marrë masat për aplikimin e penalitetit të duhur për rastet e konstatuara me problematika, duke u bazuar në procesverbalet, shpjegimet e subjektit dhe faktet përkatëse, me qëllim klasifikimin e saktë të shkeljeve dhe arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën 272,212 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së procedurave doganore lidhur me veprimtarinë e Regjimit të Magazinimit Doganor, në dy raste (Autorizim për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor nr.10099/1, datë 16.06.2023, tipi magazinës magazinë

doganore private numër identifikues magazinës C108, mbajtës i autorizimit shoqëria “T.G.A” SHPK, me NUIS M...Q dhe Autorizim për magazinë doganore private “D.F.SH” nr.14046/3 lëshuar nga MFE datë 18.08.2021 numër identifikimi CDF002, mbajtës shoqëria “T.G.A” SHPK, me NUIS M...Q) u konstatua mos penalizim të subjekteve që kanë kryer shkeljen doganore të mosplotësimit të regjistrimit të magazinimit doganor standard sipas modelit të Aneksit 5 dhe 5/1, i cili duhet të sekretohet në degën doganore mbikëqyrëse, me efekt të ardhura të munguara në shumën **100,000 lekë**, veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr.7, datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” të DPD dhe nenin 252 të Kodit Doganor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Dega Doganore Rinas, doganierët mbikëqyrës së Regjimit Magazinimit Doganor te kryejnë kontrole çdo tre muaj, të sanksionojnë mosrespektimin nga mbajtësi i autorizimit apo mbajtësi i një regjimi i detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave që mbulohen nga regjimi i magazinimit doganor, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 215 të Kodit Doganor.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, i rekomandojmë **Kryetarit të Degës Doganore Rinas dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën, proporcionalitetin dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë individuale, të bëjë vlerësimin e shkeljes dhe t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, për punonjësit si më poshtë të trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit:

-Z. E.D, me detyrë përgjegjës turni në SVQ, për moszbatim të Kodit Doganor, metodës nr.3 të vlerësimit, bazuar në Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, lidhur me praktikën doganore të kapitullit 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones të NKM, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 4,182,776 lekë.

-Znj. A.C, me detyrë doganiere në SVQ, për moszbatim të Kodit Doganor, metodës nr.3 të vlerësimit, bazuar në Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, lidhur me praktikën doganore të kapitullit 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones të NKM dhe moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “pajisjeve mjekësore” me pasojë të ardhura të munguara në shumën 3,968,177 lekë.

-Znj. E.G, me detyrë doganier në DPD, për moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “pajisjeve mjekësore”, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 5,755,800 lekë.

-Z. J.S, me detyrë doganier në SVQ, për moszbatim të Kodit Doganor, metodës nr.3 të

vlerësimit, bazuar në Udhëzimin nr.3 dhe kodin tarifor, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e transaksionit, lidhur me praktikën doganore të kapitullit 85 kodi tarifor 85171300 Smartphones të NKM, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 4,066,025 lekë.

-Z. A.B, me detyrë përgjegjës sektorit kargo në DD Rinas, për moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “paisjeve mjekësore”, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 20,594,704 lekë.

-Z. E.Z, me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas, për moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “paisjeve mjekësore”, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 2,384,056 lekë.

-Z. F.L, me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas, për moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “paisjeve mjekësore”, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 11,831,764 lekë.

-Znj. J.K, me detyrë doganier pranë sektorit Kargo në DD Rinas, për moszbatim të Kodit Doganor nenet 47, 169, 173, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.1 datë 14.02.2013 i ndryshuar “Mbi të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”, për përjashtim të padrejtë nga pagimi i TVSH-së në import për importimin e artikujve “paisjeve mjekësore”, me pasojë të ardhura të munguara në shumën 4,483,272 lekë.

-Për punonjësit e tjerë të cilësuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nuk rekomandojmë masë disiplinore pasi të metat dhe mangësitë e evidentuara janë nën pragun e materialitetit dhe më të ulëta se risku.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT